



Demokracia në Veprim  
Demokratija na Delu  
Democracy in Action

# RAPORTI I VËZHGIMIT TË ZGJEDHJEVE PARLAMENTARE 2010



Prishtinë, 2011



## Raporti i Zgjedhjeve Parlamentare 2010

Ky raport është i bazuar në formularët e vëzhguesve të Demokracisë në Veprim gjatë fushatës parazgjedhore, ditës së zgjedhjeve me 12 dhjetor 2010, si dhe në procesin e rivotimit me 09 dhe 23 janar 2011.

CCSD

CSD

Developing

Together

FID

KCIC

KDI

KHCS Mother

Theresa

Syri i Vizionit



## PËRMBAJTJA

Hyrje .....	5
Përmbledhje .....	7
Konteksti politik.....	10
Kuadri Ligjor dhe Sistemi Zgjedhor.....	12
Sistemi zgjedhor .....	13
Organet e administrimit të procesit zgjedhor .....	14
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve .....	14
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) .....	15
Gjykata Supreme .....	17
Trajnimi i Komisionerëve.....	18
Regjistrimi i Partive Politike.....	18
Listat Zgjedhore .....	19
Periudha e kundërshtimit dhe konfirmimit.....	19
Votimi përmes postës.....	19
Edukimi i votuesve.....	20
Fushata zgjedhore .....	20
Heshtja zgjedhore.....	21
Votimi 12 dhjetor 2010 .....	21
Përgatitja e vendvotimeve .....	21
Sigurimi i fshehtësisë së votës.....	25
Anëtarët e këshillit të vendvotimit.....	25
Procesi i votimit.....	26
Votimet familjare.....	27
Ambienti i Votimit .....	28
Procesi i numërimit .....	29
Koha e përfundimit të votimit.....	29
Transparenca e Numërimit.....	30
Procedurat e Numërimit.....	30
Ankesat rreth numërimit.....	32
Vlerësimi i procesit të numërimit nga ana e vëzhguesve.....	32
Vëzhgimi i transportit të kutive të votimit .....	33
Rivotimi i 9 janarit 2011 .....	33
Rivotimi 23 janar 2011.....	38
Analiza e Trendeve .....	41
Rekomandimet: .....	45

## HYRJE

Koalicioni i organizatave joqeveritare “Demokracia në Veprim”, gjatë procesit zgjedhor të zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të mbajtura me 12 dhjetor 2010, është angazhuar në dhënien e kontributit përmes një vëzhgimi të paanshëm. Për qëllim kishte sigurimin e një procesi elektoral, sipas standardeve universale për zgjedhje të lira, të drejta dhe të barabarta.

Gjatë këtij procesi, “Demokracia në Veprim”, është udhëhequr nga misioni i vet për të kontribuar në konfirmimin e një procesi të drejtë zgjedhor, ku punë parësore kishte të përfaqësuarit demokratik të qytetarëve. Qëllim tjetër i “Demokracisë në Veprim” ishte që të përfshijë sa më shumë qytetarë në ushtrimin e të drejtave dhe obligimeve në një shoqëri demokratike. Pastaj edukimin e tyre mbi procedurat themelore të votimit dhe informimin objektiv të qytetarëve për të bërë transparent procesin zgjedhor.

Përmes pjesëmarrjes së shoqërisë civile, ky Koalicion promovon pjesëmarrjen në zgjedhje të lira përmes edukimit të votuesve. Gjithashtu, promovon te drejtën dhe obligimin e qytetarëve që të jenë pjesë e procesit zgjedhor. Bashkëpunon me organizata vendore, rajonale dhe ndërkombëtare, për ndërtimin e një procesi transparent dhe vëzhgim të procesit në mënyrë të paanshme, si kontribut në avancimin e jetës demokratike në Kosovë.

“Demokracia në Veprim” është angazhuar që të bëjë vëzhgimin e situatës para-elektorale, vëzhgimin e ditës së zgjedhjeve, si dhe situatën pas-elektorale.

### I. Vëzhgimi i situatës para-elektorale

- Vëzhgimi i punës së institucioneve, të cilat administrojnë procesin zgjedhor: KQZ-të dhe KKZ-të;
- Edukimi dhe sensibilizimi i votuesve;
- Regjistrimi i votuesve ;
- Regjistrimi i subjekteve politike dhe kandidatëve ;
- Vëzhgimi i fushatës parazgjedhore;
- Vëzhgimi i kostos financiare të partive politike gjatë fushatës zgjedhore.

### II. Vëzhgimi i ditës së zgjedhjeve

- Vëzhgimi i procedurave të votimit;
- Vëzhgimi i procedurave të numërimit të rezultateve;
- Publikimi i rezultateve preliminare (PVT);
- Vëzhgimi i bartjes së kutive të votimit për në Qendrën e Numërimit dhe të Rezultateve.

### III. Vëzhgimi i situatës pas-elektorale

- Vëzhgimin e procesit të ankimimit dhe certifikimit të rezultateve përfundimtare;
- Publikimin e raporteve për tërë procesin elektoral, si dhe nxjerrja e rekomandimeve.

“Demokracia në Veprim”, në zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 12 dhjetorit 2010, ka pasur të angazhuar 5000 vëzhgues, prej të cilëve 2280 në të gjitha vendvotimet dhe gjatë procesit të votimit, kurse 2280 vëzhgues të tjerë gjatë procesit të numërimit. “Demokracia në Veprim”, po ashtu ka angazhuar edhe mbi 200 vëzhgues në ekipe mobile, 200 vëzhgues të tjerë në qendrën e thirrjeve dhe komunikimit me publikun, si dhe 150 vëzhgues për monitorimin e fushatës para-zgjedhore.

Koalicioni “Demokracia në Veprim”, falënderon 5000 vëzhguesit e angazhuar për profesionalizmin, për paanshmëri, për përkushtim, si dhe për komunikim me etikë në raportimin e vërejtjeve nga vendvotimet.

Koalicioni “Demokracia në Veprim”, falënderon organizatat partnere nga shoqëria civile dhe mediat, të cilat e kanë mbështetur dhe prezentuar punën e “Demokracisë në Veprim”.

“Demokracia në Veprim”, falënderon Ambasadat e shteteve të vendosura në Kosovë, të cilat kanë dhënë mbështetje të pazërvë në funksionimin e Koalicionit, me qëllim të ndërtimit të një shoqërie demokratike në Kosovë.

“Demokracia në Veprim” nëpërmjet këtij Raporti paraqet të gjeturat përfundimtare për procesin e Zgjedhjeve Parlamentare të 12 dhjetorit 2010 .

Koalicioni “Demokracia në Veprim” ka në përbërjen e saj organizatat si në vijim: CCSD (përgjegjëse për për komunitat në veri të Kosovës); CSD (përgjegjëse për Graçanicën dhe pjesët e tjera në qendër dhe jug të Kosovës); Developing Together (përgjegjëse për një pjesë të Prishtinës, Lipjanin dhe Drenasin); FID (përgjegjës për Gjakovën, Malishevën dhe Rahovecin); KCIC (përgjegjës për Gjilanin, Kamenicën dhe Vitinë); KDI (organizatë e cila në vitin 2009 dhe aktualisht udhëheq koalicionin “Demokracia në Veprim”, si dhe është përgjegjëse për Prizrenin, Dragashin, Suharekën dhe Mamushën); Shoqata Nëna Terezë (përgjegjëse për një pjesë të Prishtinës, Podujevën, Fushë Kosovën dhe Obiliqin) dhe Syri i Vizionit (përgjegjës për Pejën, Istogun, Klinën, Deçanin dhe Junikun).

## PËRMBLEDHJE

Gjatë vitit 2010, Kosova, ka kaluar një rëndësishme zhvillim të politikave dhe institucionale që pas shpalljes së Pavarësisë.

Pas miratimit të mocionit të mosbesimit nga ana e Kuvendit, ushtruesi i detyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës, z. Jakup Krasniqi, në përputhje të plotë me kompetencat e tij të garantuara me Kushtetutën e Kosovës, nxori dekretin që të shpërndajë Kuvendin e Kosovës. Po ashtu, mori vendim që të ndryshojë edhe datën e mbajtjes së zgjedhjeve nga 13 shkurti 2011 që ishte vendosur më herët, në 12 dhjetor 2010, në pajtim me afatet kushtetuese dhe ligjore në Kosovë.

Kosova tani për herë të parë po përballëj me organizimin e zgjedhjeve të parakohshme. Skenës politike kosovare, po përgatiteshin t'i bashkangjiten edhe dy subjekte të reja politike, të cilat garonin për herë të parë në zgjedhje. Lëvizja "Vetëvendosje!" e udhëhequr nga Albin Kurti, u certifikua si lëvizje politike dhe u bë konkurrenë në garën zgjedhore. Në anën tjetër, udhëheqës të shquar të shoqërisë civile kosovare formuan partinë "Fryma e Re" (FER), e cila gjithashtu u certifikua për pjesëmarrje në garë për Kuvendin e Kosovës.

Zgjedhjet parlamentare të 12 dhjetorit 2010, u organizuan dhe u zhvilluan në bazë të nenit 66 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe në bazë të ligjit nr. 03/I-256 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/I-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës të ndryshuar në tetor të vitit 2010<sup>1</sup>.

Deputetët e Kuvendit të Kosovës zgjidhen sipas sistemit proporcional me lista të hapura, në kombinim me votimin preferencial për kandidatët e subjekteve politike. Votuesi pajiset me një fletëvotim të vetëm për zgjedhje, ku e shënjon votën për një (1) subjekt politik, si dhe në listën e njëjtë mund të shënojë edhe pesë vota për pesë (5) kandidatë nga lista e subjektit politik për të cilin ka votuar votuesi. Në këtë kontekst, ndryshim tjetër i rëndësishëm është fakti i përcaktimit të afateve të ankesave dhe shqyrtimi i tyre nga PZAP dhe Gjykata Supreme. Vendimet e PZAP-it janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga KQZ-ja, përveçse, në rast se apeli i lejuar parashtrohet brenda kohës së paraparë dhe, nëse Gjykata Supreme e përcakton ndryshe. Kjo dallon nga praktika e kaluar, ku vendimet e KZAP-it të atëhershëm ishin vetëm udhëzime (fakultative) dhe jo të karakterit detyrues (imperative)<sup>2</sup>.

Duhet vlerësuar se ndryshimet e bëra në Ligjin për zgjedhjet e përgjithshme, (sidomos përcaktimi i afateve kohore për PZAP dhe Gjykatën Supreme), kanë dhënë rezultate pozitive në përmbylljen e procesit zgjedhor deri tek certifikimi i rezultateve.

<sup>1</sup> [http://www.kqz-ks.org/SKQZ-WEB/al/legjislacioni/materiale/ligjetezgjedhjeve/GZRK\\_87\\_al.pdf](http://www.kqz-ks.org/SKQZ-WEB/al/legjislacioni/materiale/ligjetezgjedhjeve/GZRK_87_al.pdf)

<sup>2</sup> Neni 118 pika e 5 i Ligjit për ndryshim dhe plotësimin e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, edhe pse ka pasur një kohë relativisht të shkurtër në organizmin e procesit zgjedhor, ka treguar një nivel të lartë të angazhimit gjatë përgatitjes së zgjedhjeve. Rregullat dhe Udhëzimet e KQZ-së kanë ndihmuar në mbarëvajtjen e procesit zgjedhor. Megjithatë, përkundër këtij angazhimi, janë vërejtur disa parregullsi, të cilat në një masë kanë ndikuar në dëmtimin e procesit zgjedhor.

Mbledhjet e KQZ-së kanë qenë të hapura, ku janë përcjellë edhe nga vëzhguesit dhe përfaqësuesit e mediave. Por, puna e KQZ-së është ndikuar nga përkatësia partiake e anëtarëve të Komisionit.

Për zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 12 dhjetorit 2010 u regjistruan 29 subjekte zgjedhore. Prej tyre 26 ishin parti politike dhe koalicione, ndërsa 3 sosh ishin iniciativa qytetare, ku në total aplikuan me 1266 kandidatë për deputetë të Kuvendit të Kosovës.

Lista Përfundimtare e Votuesve (LPV) për Zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës 2010 bazohet në Ekstraktin e Regjistrimit Civil, i cili është përpiluar nga Agjencia për Prodhimin e Dokumenteve (APD), në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Lista Përfundimtare e Votueseve për zgjedhjet e 12 dhjetorit 2010 kishte 1, 630, 636 emra të votuesve të ndarë në 37 komuna, me një rritje prej 73,288 apo 4,4% në krahasim me zgjedhjet e kaluara. Numri i Qendrave të Votimit (QV) ishte 746, ndërsa numri i vendvotimeve 2280, ku rezultoi me një rritje prej 24 vendvotime apo 1.0 % nga zgjedhjet e kaluara.

Përkundër faktit që KQZ-ja ka bërë një punë të mirë për pastrimin e listave të votuesve, ky problem në një masë shumë të madhe është ende i pranishëm.

Bazuar në Rregullën Zgjedhore të KQZ-së me nr. 15/2010 për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme dhe të zgjedhjet e parakohshme, fushata zgjedhore ishte shkurtuar në vetëm dhjetë ditë, ku përfundoi një ditë para ditës së zgjedhjeve<sup>3</sup>.

Edhe pse koha ishte e kufizuar për fushatë elektorale (vetëm 10 ditë), megjithatë, ranë në sy shpenzimet e mëdha të subjekteve politike gjatë fushatës elektorale, sidomos të partive të mëdha.

Duke u bazuar në raportimet e vëzhguesve të “Demokracisë në Veprim”, përgatitja e vendvotimeve në ditën e zgjedhjeve të 12 dhjetorit 2010 në pjesën më të madhe të vendvotimeve (84,9% të vendvotimeve) kishte filluar në kohën e duhur në mes orës 06:00 – 07:00. Megjithatë, në 10% të vendvotimeve, u evidentuan vonesa në aspektin e përgatitjes së vendvotimeve, ku në këto raste përgatitjet zhvillohen në mes orës 07:00 – 08:00.

Nga materialet teknike, si: llamba ultravjollcë, lista e votuesve dhe të tjera kishin munguar në 10,7% të vendvotimeve. Përveç mungesës së këtyre materialeve, janë raportuar raste kur edhe

---

<sup>3</sup> Rregulla e KQZ-së për Zgjedhjet e jashtëzakonshme dhe të parakohshme.



pse llambat UV ishin prezente nuk kanë qenë plotësisht funksionale, për shkak të baterive të dobëta apo për shkak se spreji nuk ka qenë i një cilësie të duhur.

Procesi i votimit në Zgjedhjet Parlamentare të 12 dhjetorit 2010 ishte zhvilluar në një ambient të qetë, me një numër të caktuar të incidenteve. Atmosfera e qetë nëpër vendvotime nuk ishte ruajtur deri në përfundim të procesit. Ky fenomen ishte kryesisht për shkak të propagandës politike brenda vendvotimit, për shkak të tollovide të shaktuara në korridore apo tensioneve në mes të vëzhguesve dhe anëtarëve të KVV-ve. Po ashtu, ndër faktorët që ndikuan në prishjen e procesit të qetë të votimit ishin edhe tentimet për të votuar më shumë se një herë, apo tentimet për të asistuar më shumë se një herë gjatë votimit, si dhe ndërprerja e kohëpaskohshme e energjisë elektrike.

Në mbi 60% të vendvotimeve procesi i votimit kishte përfunduar midis orës 19:00 – 20:00, kurse në 36.3% të vendvotimeve ato ishin mbyllur prej orës 18:00 – 19:00<sup>4</sup>. Vetëm në njëmbëdhjetë vendvotime vonesat kishin zgjatur deri në orën 21.00, dhe në gjashtëmbëdhjetë vendvotime të tjera raportohet për vonesa edhe pas orës 21.00.

Në bazë të vlerësimit të vëzhguesve të procesit të numërimit të 12 dhjetorit 2010, raportohet për një numër të caktuar të parregullsive gjatë këtij procesi, të cilat në masë të caktuar kanë ndikuar në rezultatin final. Nga raportimet e vëzhguesve të “Demokracisë në Veprim”, më së shumti parregullsi u evidentuan në rastet ku fletëvotimet në kuti tejkalonin numrin e të nënshkuarve në regjistrin e votuesve, sidomos ky fenomen kishte ndodhur në Komunën e Skenderajt dhe në atë të Drenasit. Po ashtu, raportohet për raste të falsifikimit të nënshkrimeve në Listën e Përfundimtare të Votuesve (ku një person ka nënshkuar për disa të tjerë). Veprimet e tilla duhet t’i vënë në lëvizje institucionet kompetente, sidomos Prokurorinë e Shtetit. Personat e përfshirë në këto manipulime duhet t’u shqiptohen dënimet e merituar.

Përgatitja e vendvotimeve gjatë procesit të rivotimit të 9 janarit 2011 (në 80,5% të vendvotimeve) ishte bërë midis orës 06:00 – 07:00. Në këtë proces ishin të angazhuar gjithsej 1335 anëtarë të Këshillave të Vendvotimeve, me një mesatare prej 7 anëtarësh për vendvotim.

Ambienti i votimit i 9 janarit 2011 paraqitet kryesisht i qetë, edhe pse u evidentuan raste të prishjes së kësaj atmosfere të qetë në disa vendvotime.

Në bazë të vlerësimeve të vëzhguesve në pjesën më të madhe të vendvotimeve (apo në 81,3% të tyre), numërimi kishte funksionuar normal, kurse në pjesën tjetër të vendvotimeve hasen parregullsi, ku në një masë kanë ndikuar në rezultatin përfundimtar.

---

<sup>4</sup> Dallimi i shprehur në minuta midis orës 18.00 – 19.00 dhe asaj 19.00-20.00 nuk mund të vlerësohet nga format e plotësuara të vëzhguesve.

Përgatitja e vendvotimeve në rivotimin e 23 janarit 2011 në Komunën e Mitrovicës, në pjesën më të madhe të vendvotimeve (apo në 78,8% të tyre) ishte bërë midis orës 06:00 dhe 07:00. Kjo kishte rezultuar me hapjen me kohë të të gjitha vendvotimeve.

Materialet, si p.sh. informatat si duhet të votohet, lista e subjekteve politike apo lista e kandidatëve ishin të pranishme në të gjitha vendvotimet. Po ashtu, për dallim nga zgjedhjet e 12 dhjetorit 2010, materialet si llambat ultravjollcë apo spreji ishin të një cilësie më të lartë, pasi që nuk u raportuan probleme në këtë aspekt.

Në përgjithësi, vlerësimi i vëzhguesve të “Demokracisë në Veprim” për rivotimin e 23 janarit 2011 është që (në 51,2% të vendvotimeve) procesi i numërimit funksionoi normal dhe pa probleme. Në një vendvotim u evidentua një rast i parregullsisë, gjë që nuk ndikoi në rezultat. Rasti tjetër kishte të bënte me një vendvotim, ku anëtarët e KVV-së plotësuan vendet e zbrazëta për kandidatë apo për subjekt politik në bazë të preferencave të tyre.

## KONTEKSTI POLITIK

Kosova gjatë vitit 2010, ka kaluar një rënë ndër zhvillimet më të rëndësishme politike dhe institucionale që pas shpalljes së Pavarësisë.

Në qershor të vitit 2010, tridhjetë e dy deputetë (32) të Kuvendit të Kosovës parashtruan kërkesë pranë Gjykatës Kushtetuese. Ata pretendonin se Presidenti, z. Fatmir Sejdiu, ka shkelur Nenin 88 (2) të Kushtetutës së Kosovës, ku me këtë ka sfiduar kushtetutshmërinë, duke mbajtur në të njëjtën kohë postin e Presidentit të vendit dhe atë të Kryetarit të Lidhjes Demokratike të Kosovës.

Në shtator të vitit 2010, Gjykata Kushtetuese nxjerr aktgjykimin për shkelje serioze të Kushtetutës së Kosovës, respektivisht të Nenit 88.2 nga z. Fatmir Sejdiu, duke mbajtur njëkohësisht postin e Presidentit të Republikës së Kosovës, si dhe postin e Kryetarit të Partisë Politike - Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK)<sup>5</sup>.

Pas këtij aktgjykimi të Gjykatës Kushtetuese, Presidenti i Kosovës, z. Fatmir Sejdiu, jep dorëheqje nga pozita e Presidentit të Kosovës. Pas dorëheqjes së Presidentit, dy partitë më të mëdha kosovare që ishin në koalicion dhe udhëhiqnin me institucionet qendrore (parlamentin, qeverinë dhe presidencën,) nuk arrijnë të krijojnë një marrëveshje të re, sipas së cilës do të zgjidhej presidenti i ri i Kosovës. Pas këtyre mosmarrëveshjeve midis partnerëve të koalicionit, bazuar në kushtetutë, mandatin e presidentit, si ushtrues detyre, filloi ta ushtronte, Kryetari i Kuvendit të Kosovës.

Partitë politike zhvilluan agjendat e tyre politike dhe i artikuluan kërkesat për zgjedhje të parakohshme, si dalje nga kjo situatë politike.

---

<sup>5</sup> <http://www.gjk-ks.org>

Kryetari i Kuvendit dhe njëherit ushtruesi i detyrës së presidentit, z. Jakup Krasniqi, më 15 tetor 2010, publikoi vendimin sipas të cilit zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës do të mbahen më 13 shkurt 2011. Ky vendim është marrë, duke u bazuar në nenin 90 dhe në nenin 84 pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe në nenin 4 pika 3 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë, si dhe me marrëveshje me partitë politike dhe Komisionin Qendror Zgjedhor<sup>6</sup>.

Pas këtij vendimi tashmë të shpallur nga ushtruesi i detyrës së presidentit, partia politike e udhëhequr nga Fatmir Sejdiu (LDK), një ditë pas shpalljes së datës për zgjedhje vendos të dalë nga koalicioni qeverisës. Dalja e Lidhjes Demokratike nga koalicioni, pasohet me veprimet për tërheqjen e zëvendëskryeministrit, ministrave dhe zëvendësministrave nga dikasteret që udhëhiqeshin nga kjo parti<sup>7</sup>.

Pas tërheqjes së LDK-së nga qeveria, Grupi parlamentar i Aleancës Kosova e Re, e përkrahur nga 40 nënshkrime të deputetëve, ndërmerr iniciativë për ngritjen e mocionit të mosbesimit për qeverinë Thaçi. Mocioni i mosbesimit hyn në agjendën e Kuvendit të Kosovës dhe merr mbështetje me votat e 66 deputetëve, një ishte kundër dhe pati dy abstenime.

Në bazë të debatit të zhvilluar, mocioni i mosbesimit është votuar nga deputetët e partive: Aleanca Kosova e Re, Partia Demokratike e Kosovës, Lidhja Demokratike e Dardanisë dhe pakicat. Kurse, me arsyetimet se nuk pajtohen me tekstin e mocionit të parashtruar, si dhe qëllimet që qëndrojnë prapa këtij mocioni, grupi parlamentar i LDK-së dhe ai i AAK-së u deklaruan qysh në fillim të seancës se nuk do të marrin pjesë fare në votim, gjë që edhe ashtu ndodhi.

Pas miratimit të mocionit nga ana e Kuvendit, ushtruesi i detyrës së Presidentit të Republikës, z. Jakup Krasniqi, në përputhje të plotë me kompetencat e tij të garantuara me Kushtetutën e Kosovës, nxori dekretin që të shpërndajë Kuvendin e Kosovës dhe mori vendim që të ndryshojë datën e mbajtjes së zgjedhjeve nga 13 shkurti që ishte vendosur më herët, në 12 dhjetor në pajtim me afatet kushtetuese dhe ligjore në Kosovë.

Ky vendim u mor duke u bazuar në nenin 90, në nenin 66, paragrafi 2, në nenin 84, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe në nenin 4, paragrafët 4.5 dhe 4.6 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës<sup>8</sup>.

Kosova tani për herë të parë po përballëj me organizimin e zgjedhjeve të parakohshme. Skenës politike Kosovare po përgatiteshin t'i bashkëngjiten edhe dy subjekte të reja politike të cilat garonin për herë të parë në zgjedhje. Lëvizja Vetëvendosje e udhëhequr nga Albin Kurti u certifikua si lëvizje politike dhe tani ishte konkurrenente në garën zgjedhore. Në anën tjetër nga udhëheqës të shquar nga shoqëria civile kosovare u formua partia Fryma e Re (FER) e cila gjithashtu u certifikua për pjesëmarrje në garë për Kuvendin e Kosovës.

<sup>6</sup> <http://www.president-ksgov.net>

<sup>7</sup> <http://www.voanews.com>

<sup>8</sup> <http://www.president-ksgov.net/?page=1,6,1424>

Disa nga partitë politike parlamentare të deritashme vendosen që të shkojnë si të vetme në garë për zgjedhjet parlamentare, me përjashtim të AKR-së, e cila krijoi një koalicion të gjerë me shtatë parti të tjera që ishin jashtë parlamentit, si dhe AAK-së, së cilës iu bashkua "Lista Ibrahim Rugova". Partitë nga radhët e komuniteteve pakicë gjithashtu u përcaktuan që të jenë pjesë e garës si të vetme pa ndonjë koalicion parazgjedhor.

Për zgjedhjet e 12 dhjetorit u certifikuan 29 subjekte zgjedhore, prej tyre 26 ishin parti politike dhe koalicione, ndërsa 3 ishin iniciativa qytetare, që në total aplikuan me 1266 kandidatë për deputetë të Kuvendit të Kosovës.

## KUADRI LIGJOR DHE SISTEMI ZGJEDHOR

Institucionet e Kosovës, nën mbështetjen e OSBE-së, ngritën Grupin Punues për Zgjedhje (GPZ), të përbërë nga përfaqësuesit politikë dhe përfaqësues të shoqërisë civile, qëllimi i të cilit ishte reforma e ligjit zgjedhor. Dekretimi i zgjedhjeve të parakohshme, ishte vendim i shpejtë për punën e GPZ-së. Prandaj, GPZ u fokusua në dy çështje kryesore, si: ndryshimi i votimit nga dhjetë kandidatë sa ishte më parë, në votimin preferencial me mundësi të votimit për 5 kandidatë si dhe përcaktimin e afateve kohore të parashtresave dhe ankesave nga subjektet politike dhe riemërimin dhe definimin e rolit të PZAP (Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa). Me ndryshime gati kozmetike dhe me procedurë të përsheptuar, Kuvendi i Kosovës në seancën e 29.10.2010, miratoi Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Zgjedhjet parlamentare të 12 dhjetorit 2010, u organizuan dhe u zhvilluan në bazë të nenit 66 (1) të Kushtetutës së Republikës dhe në bazë të ligjit nr. 03/l-256 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/l-073 për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës të ndryshuar në tetor të vitit 2010<sup>9</sup>.

Megjithatë, për shkak të afatit të shkurtër kohor për reformim të mirëfilltë, ndryshimi sipërfaqësor i ligjit zgjedhor la shumë çështje pa zgjidhur si: shkalla e pragut zgjedhor, ndarja e Kosovës në më shumë zona elektorale etj. Ky proces, u shoqërua me debate të nxehta nga shoqëria civile dhe nga subjektet politike më të vogla, që nuk ishin të përfaqësuara në Parlament dhe nuk kishin përfaqësim në GPZ.

Pas ndryshimit të ligjit zgjedhor, KQZ nxjerr rregullën zgjedhore nr. 15/2010 për zgjedhjet e jashtëzakonshme dhe zgjedhjet e parakohshme. Në dispozitat e përgjithshme të kësaj Rregulloreje përcaktohet se zgjedhjet e jashtëzakonshme dhe zgjedhjet e parakohshme organizohen dhe qeverisen përmes ligjeve të njëjta dhe rregullave zgjedhore të KQZ-së, sikurse edhe zgjedhjet e

<sup>9</sup> [http://www.kqz-ks.org/SKQZ-WEB/al/legjislacioni/materiale/ligjetezgjedhjeve/GZRK\\_87\\_al.pdf](http://www.kqz-ks.org/SKQZ-WEB/al/legjislacioni/materiale/ligjetezgjedhjeve/GZRK_87_al.pdf)

tjera, përveç se KQZ-ja mund të ndryshojë afatet kohore, në rast se kjo nevojitet për shkak të rrethanave.

Ligji për zgjedhjet e përgjithshme krijon hapësirë dhe ia jep të drejtën KQZ-së që më tutje të rregullojë shumë aspekte të rëndësishme të procesit zgjedhor, përmes miratimit të Rregullave Zgjedhore. Nga viti 2008 deri më tash, KQZ ka nxjerrë pesëmbëdhjetë (15) Rregulla të ndryshme Zgjedhore.

### **Sistemi zgjedhor**

Deputetët e Kuvendit të Kosovës zgjidhen sipas sistemit proporcional me lista të hapura në kombinim me votimin preferencial për kandidatët e subjekteve politike.

Nëse në një fletëvotim shënjohe më shumë se pesë (5) kandidatë, atëherë numërohet vetëm vota e hedhur për subjektin politik<sup>10</sup>. Fletëvotimi përbëhet nga lista, ku votuesi mund të shënojë votën e tij. Votuesi së pari duhet të zgjedhë numrin e subjektit politik, të cilin e preferon dhe pastaj mund të votojë deri në pesë numra të kandidatëve nga ajo parti. Lista e kandidatëve, kryesisht përbëhet nga 110 kandidatë dhe votimi për kandidat është opsional. Nëse votuesi ka preferenca mund të votojë deri në pesë kandidatë, ose në të kundërtën nëse votuesi nuk ka preferenca për kandidatë, atëherë mund të votojë vetëm për subjektin politik.

Nëse votuesi gabon në listën e parë për subjektin politik, atëherë fletëvotimi i tij/saj konsiderohet si i pavlefshëm. Kurse, në anën tjetër, nëse votuesi voton më shumë se pesë kandidatë, atëherë vota do të jetë e vlefshme, por do të numërohet vota vetëm për subjektin politik.

Ndryshimi i ligjit zgjedhor, si dhe krijimi i mundësisë për votim preferencial deri në pesë kandidatë, u arsyetua nga subjektet politike në favor të përfaqësimit gjinor (gjinisë femërore). Kjo u pa si formë më e mirë për të krijuar mundësi të përfaqësimit me votime të larta dhe jo vetëm si garantë e kuotës 30% për përfaqësim gjinor.

Bazuar në dispozitat kushtetuese, Kuvendi ka njëqind e njëzet (120) deputetë të zgjedhur me votim të fshehtë, bazuar në listat e hapura. Vendet në Kuvend ndahen midis të gjitha partive, koalicioneve, nismave qytetare, si dhe kandidatëve të pavarur, në përpjesëtim me numrin e votave të vlefshme, të fituara prej tyre në zgjedhjet për Kuvendin.

Në kuadër të kësaj ndarjeje, njëzet (20) prej njëqind e njëzet (120) vendeve janë të garantuara për përfaqësimin e komuniteteve, që nuk janë shumicë në Kosovë, si vijon: komuniteti serb dhjetë (10) vende; komuniteti rom një (1) vend; komuniteti ashkali një (1) vend; komuniteti egjiptian një (1) vend, si dhe një (1) vend shtesë do t'i jepet komunitetit rom, ashkali, ose egjiptian, që ka

---

<sup>10</sup> Ligji për Ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

numrin më të madh të votave të përgjithshme. Pastaj komuniteti boshnjak ka tri (3) vende, komuniteti turk dy (2) vende dhe komuniteti goran një (1) vend<sup>11</sup>.

## ORGANET E ADMINISTRIMIT TË PROCESIT ZGJEDHOR

### Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Zgjedhjet e 12 dhjetorit 2010, ishin zgjedhjet e para parlamentare dhe të parakohshme, ku Komisioni Qendror Zgjedhor (KQZ) ishte në tërësi përgjegjës për organizimin dhe administrimin e tyre.

Kushtetuta e Kosovës në nenin 139 të saj, e ka përcaktuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ-në), si organin e përhershëm, i cili përgatit, mbikëqyr, drejton dhe verifikon të gjitha veprimet, që kanë të bëjnë me procesin e zgjedhjeve e referendumet dhe shpall rezultatet e tyre.

Ky institucion në përbërjen e vet ka 11 anëtarë. Kryesuesin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve e emëron Presidenti i Republikës së Kosovës nga radhët e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme dhe të Gjykatave me juridiksion apeli. Gjashtë (6) anëtarë emërohen nga pjesëtarët e gjashtë grupeve më të mëdha parlamentare të përfaqësuara në Kuvend, të cilët nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në ndarjen e vendeve të rezervuara. Nëse në Kuvend janë të përfaqësuara më pak grupe, grupi a grupet më të mëdha mund të emërojnë anëtarë shtesë. Një (1) anëtar emërohet nga deputetët e Kuvendit, të cilët mbajnë vende të rezervuara a të garantuara për komunitetin serb të Kosovës, si dhe tre (3) anëtarë nga deputetët e Kuvendit, të cilët mbajnë vende të rezervuara a të garantuara për komunitetet e tjera, që nuk janë shumicë në Kosovë<sup>12</sup>.

Organ shumë i rëndësishëm brenda këtij institucioni është Sekretariati i KQZ-së, i cili asiston KQZ-në në zbatimin e funksioneve dhe përgjegjësi, të cilat i janë caktuar me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme. Po ashtu, trupa të një rëndësie shumë të veçantë janë edhe Komisionet Komunale Zgjedhore apo (KKZ-të), të cilat shtrihen në tridhjetë e shtatë (37) komunat e Republikës së Kosovës. KKZ-të janë përgjegjëse t'i administrojnë zgjedhjet përbrenda komunës së tyre gjegjëse, nën mbikëqyrjen ekskluzive dhe udhëzimet e KQZ-së që vepron përmes Sekretariatit, duke garantuar ligjshmëri, legjitimitet dhe efikasitet të procesit zgjedhor. KKZ-të përbëhen nga shtatë (7) anëtarë dhe emërohen brenda pesëmbëdhjetë ditëve pas shpalljes së zgjedhjeve.

Në fund të këtij organogrami, vijnë Këshillat e Vendvotimeve (KVV), të cilat janë përgjegjëse për sigurimin e integritetit, sigurisë dhe të qetësisë në procesin e votimit dhe numërimit në vendvotim, nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë nga KKZ-ja, e që në total kapin shifrën e 2280 Këshillave të Vendvotimeve.

<sup>11</sup> Kushtetuta e Kosovës kapitulli IV neni 64.1 & 64.2

<sup>12</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës – neni 139

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, edhe pse ka pasur një kohë relativisht të shkurtër në organizmin e procesit zgjedhor, ka treguar një nivel të lartë të angazhimit gjatë përgatitjes së zgjedhjeve. Rregullat dhe Udhëzimet e KQZ-së kanë ndihmuar në mbarëvajtjen e procesit zgjedhor. Megjithatë, përkundër këtij angazhimi, janë vërejtur disa parregullsi, të cilat në një masë kanë ndikuar në dëmtimin e procesit zgjedhor. Parregullsitë e evidentuara konsistojnë në raste, ku materiali i domosdoshëm zgjedhor nuk ka qenë i pranishëm në të gjitha vendvotimet ose ka shkuar me vonesë në disa prej tyre. Në disa vendvotime nuk kanë funksionuar fare llambat ultravjollcë, për shkak të kualitetit të dobët të tyre edhe ky fenomen është vërejtur në një numër të madh të qendrave të votimit anekënd Kosovës. Në disa qendra, sprej për spërkatjen e gishtit, ka qenë i nivelit tejet të dobët. Zgjedhja jo e duhur e anëtarëve të KVV-ve në disa komuna të Kosovës (ku ishin përfshirë në manipulimin e votave), rezultoi me përsëritjen e votimeve në disa komuna të Kosovës.

Probleme të tjera që e kanë përcjellë punën e KQZ-së gjatë përgatitjeve zgjedhore, kanë qenë vonesat në informimin e qytetarëve në lidhje me ndërrimet e vendvotimeve, vonesat në edukimin e qytetarëve për të votuar, trajnimi jo adekuat i komisionerëve zgjedhorë etj.

Mbledhjet e KQZ-së kanë qenë të hapura dhe janë përcjellë nga vëzhguesit dhe përfaqësuesit e mediave. Por, puna e KQZ-së është ndikuar nga përkatësia partiake e anëtarëve të Komisionit. “Nevojitet përforsimi i mëtejshëm i integritetit të KQZ-së në procesin e vendimmarrjes, përmes zvogëlimit të ndikimit të partive politike për punën e saj”<sup>13</sup>, thuhet në raportin e vëzhguesve evropian ENEMO. Kjo do të mundësonte fuqizimin e këtij institucioni në administrimin e procesit zgjedhor.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**

Praktikat e mëparshme elektorale në Kosovë, nxorën në pah disa probleme apo zbrazëti në legjislacionin aktual zgjedhor, me theks të veçantë me afatet e ankimit, si dhe kompetencën e organeve që merren me ankesat e subjekteve politike, kandidatëve dhe të gjithë atyre që pretendojnë se i është e shkelur ndonjë e drejtë gjatë procesit zgjedhor. Kuvendi i Kosovës, në tetor 2010, amendamenti Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë, ku ndryshimi përmbajtësor i tij kishte të bënte me përcaktimin e afateve të ankesave dhe shqyrtimi i tyre nga PZAP dhe Gjykata Supreme.

Ndryshim tjetër i rëndësishëm në këtë kontekst është fakti se, vendimet e PZAP-it, janë të detyrueshme për t’u zbatuar nga KQZ-ja, përveçse, në rast se apeli i lejuar parashtrohet brenda kohës së paraparë dhe nëse Gjykata Supreme përcakton ndryshe. Kjo dallon nga praktika e kaluar, ku vendimet e KZAP-it të atëhershëm ishin vetëm udhëzime (fakultative) dhe jo të karakterit detyrues (imperative)<sup>14</sup>. Përbërja e PZAP-së është si në vijim: Kryetari i Gjykatës Supreme emëron

<sup>13</sup> Raporti i ENEMO-s

<sup>14</sup> Neni 118 pika e 5 I Ligjit për ndryshim dhe plotësimin e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme.

kryesuesin e PZAP-it nga mesi i gjykatësve të Gjykatës Supreme, si dhe emëron anëtarët nga mesi i gjykatësve të gjykatave të qarkut. PZAP-i përbëhet nga dhjetë (10) anëtarë, përfshirë edhe kryesuesin. PZAP-i mund të mbledhet në seanca të ndara me nga së paku tre (3) anëtarë<sup>15</sup>.

PZAP është organ i përhershëm, i pavarur, kompetent për të vendosur në lidhje me ankesat dhe apelet e lejuara që kanë të bëjnë me procesin zgjedhor, siç është caktuar me Ligjin për zgjedhjet e përgjithshme dhe rregullat zgjedhore.

Gjatë procesit zgjedhor të 12 dhjetorit 2010, para dhe pas datës 12 dhjetor në PZAP, janë parashtruar në total 363 ankesa nga subjektet politike dhe shoqëria civile. Nga kjo shifër, janë refuzuar apo janë hedhur si të pabaza 238 ankesa nga ana e PZAP-it, ndërkaq janë aprovuar gjithsej 125 sosh, përfshirë këtu edhe 99 ankesa të aprovuara me gjoba.

Për shkak të numrit të madh të ankesave, të bazuara në fakte bindëse për Panelin Zgjedhor, ky i fundit, mori vendim që të udhëzojë KQZ-në për përsëritjen zgjedhjeve në disa komuna: Drenas, Skenderaj dhe Deçan, si dhe përsëritjen e procesit të votimit në Komunën e Lipjanit dhe të Malishevës. Bazuar në vendimet dhe udhëzimet e PZAP-it, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e mbajtur më 16.12.2010, mori vendim për përsëritjen e votimit të zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Kosovës në komunat e lartpërmendura, ku vendosi për 9 janar 2011.

KQZ për shkak të parregullsive të mëdha, që e kishin shoqëruar procesin zgjedhor të 12 dhjetorit, në ato komuna që duhej të përsëritej votimi, mori vendim që të ndërrohen anëtarët e Këshillave të Vendvotimit. Megjithatë, "Demokracia në Veprim" vlerësoi se edhe përkundër ndërrimit të komisionerëve nga ana e KQZ-së, nuk janë shmangur e parregullsitë.

Bazuar në numrin e madh të ankesave, të proceduara në PZAP, edhe pas procesit të rivotimit, nxirret përfundimi se edhe ky proces është përcjellë me një varg parregullsisht. Në total numri i ankesave të arritura në PZAP, pas procesit të rivotimit arriti shifrën 71, ku 46 ankesa janë refuzuar si të pabaza nga PZAP-i, ndërsa 25 janë aprovuar, përfshirë këtu edhe 1 ankesë të aprovuar me gjobë.

Megjithatë, organet ankimese, në këtë rast shkalla e dytë dhe fundit e ankimit, Gjykata Supreme më 6 janar 2011, nxori aktgjykimin, ku miratoi ankesën e subjektit politik Lëvizja "Vetëvendosje!", ku pretendohet se në 24 qendra të votimit në Komunën e Mitrovicës, nuk kanë funksionuar llambat ultravjollcë. Gjykata Supreme, me këtë aktgjykim e udhëzoi KQZ-në që të shpallë rivotim në 24 qendra në Komunën e Mitrovicës. KQZ më 10 janar, mori vendim për përsëritjen e zgjedhjeve edhe në këtë komunë. Numri i ankesave, të cilat janë adresuar në PZAP, lidhur me procesin e rivotimit në Komunën e Mitrovicës ishin gjithsej 11 sosh. Të gjitha këto ankesa, Paneli zgjedhor i refuzoi si të pabaza.

---

<sup>15</sup> Neni 116.1 i Ligjit për ndryshim dhe plotësimin e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme.



Duhet vlerësuar se ndryshimet e bëra në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme, sidomos, përcaktimi i afateve kohore për PZAP-in dhe Gjykatën Supreme, kanë dhënë rezultate pozitive në përmbylljen e procesit zgjedhor deri tek certifikimi i rezultateve.

Deklaratat publike të Prokurorit të shtetit, se janë iniciuar rreth 130 raste të hetimeve ndaj personave që dyshohej, se kanë qenë pjesë e manipulimeve apo keqpërdorimeve gjatë procesit zgjedhor, ishte një lajm i mirëpritur nga opinioni publik. Prokurori i shtetit deklaroi, gjithashtu, se personat që dëmtuan këtë proces të vendosen para drejtësisë. Dënimi eventual i personave përgjegjës nga ana e sistemit gjyqësor, do të shërbente si një preventivë e mirë, që parregullsitë, manipulimet dhe keqpërdorimet të mos përsëriten në proceset e ardhshme elektorale.

### Gjykata Supreme

Ligji zgjedhor, ka përcaktuar mundësinë e apelimit të vendimeve të PZAP-it, sikurse, që PZAP-i mund të rishikojë cilindo nga vendimet e marra, pas prezentimit të fakteve të reja nga pala e interesuar. Ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës, mund të paraqitet brenda njëzet e katër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë se sa pesëmijë (5.000) euro ose në rast se, çështja prek një të drejtë themelore. Gjykata Supreme vendos në afatin prej shtatëdhjetë e dy (72) orëve pas paraqitjes së apelit<sup>16</sup>.

Gjatë procesit elektoral të zgjedhjeve parlamentare të 12 dhjetorit 2010, Gjykata Supreme ka trajtuar një ankesë kundër vendimit të PZAP-it, të ngritur nga Lëvizja “Vetëvendosje!”. Gjykata Supreme pas pranimit të ankesës, kishte konstatuar se duhet lënda duhet të kthehet edhe një herë për trajtim në PZAP për dhënien e një vendimi meritor. Përkundër kësaj, PZAP-i edhe një herë kishte vendosur më 31 dhjetor 2010, se ankesa e Lëvizjes “Vetëvendosje!”, për mos funksionimin e llambave fluoroeshente në momentet e para të fillimit të votimit në disa qendra në Komunën e Mitrovicës, assesi nuk ishte fakt, i cili do të ndikojë në rezultatet finale. Prandaj, për këtë arsye, Paneli ka gjetur si jo të domosdoshme përsëritjen e votimit në ato qendra të përfshira në ankesë<sup>17</sup>.

Megjithatë, përkundër këtij vlerësimi të PZAP-it, Gjykata Supreme, më 6 janar 2011, nxori aktgjykimin, i cili anuloi vendimin e PZAP-it dhe me këtë rast kërkoi që të anuloheshin rezultatet, si dhe urdhëroi KQZ-në që t'i përsërisë votimet në 24 qendra në Komunën e Mitrovicës. KQZ më 10 janar 2011, vendosi që zgjedhjet të përsëriten në tërë territorin e Komunës së Mitrovicës.

“Demokracia në Veprim”, aktgjykimin e 6 janarit, të nxjerrë nga Gjykata Supreme, e ka konsideruar se nuk është marrë në përputhje me afatet kohore të përcaktuara në Ligjin për zgjedhjet. Dispozitat e këtij ligji, i japin Gjykatës Supreme afat prej 72 orësh pas paraqitjes së apelit, për të marrë vendim ndaj ankesave që i atakojnë vendimet e PZAP-it. Aktgjykimi i Gjykatës

<sup>16</sup> Neni 118 pika 4 e Ligjit për ndryshim dhe plotësimin e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme.

<sup>17</sup> Vendimi i PZAP-it më 31.12.2010 nr. 442/2010

Supreme, është marrë diku 16 ditë pas përfundimit të afateve kohore, të përcaktuara me Ligjin për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme.

Objekt i trajtimit i Gjykatës Supreme, ishin edhe 6 ankesat e kandidatëve të disa subjekteve politike, kundër vendimeve të PZAP-it, ku i kishte hedhur si të pa baza ankesat e tyre, ku pretendohet se u janë manipuluar votat gjatë procesit të numërimit. Po ashtu, Gjykata Supreme, të gjitha këto ankesa i refuzoi si të pa bazuara.

## TRAJNIMI I KOMISIONERËVE

Koha e shkurtër për përgatitjen e zgjedhjeve ka qenë një sfidë edhe në trajnimin e anëtarëve të KKZ-ve dhe KVV-ve. Disa nga parregullsitë dhe shkeljet e dispozitave ligjore, të vërejtura në qendrat e votimit nga monitoruesit e “Demokracisë në Veprim”, kishin të bënin me trajnimin jocilësor dhe jo të mjaftueshëm të anëtarëve të KZZ-ve dhe KVV-ve. Shkaki krejt kësaj ishte organizimi i trajnimeve në intervale të shkurtra kohore dhe jo shumë cilësore. Sa i përket trajnerëve për komisionerë, KQZ kishte rekomanduar që trajnerët e angazhuar gjatë zgjedhjeve lokale të vitit 2009, duhet të jenë edhe në zgjedhjet e vitit 2010. Nga raportet e KQZ-së, shihet se shumica nga trajnerët e 2009 janë angazhuar edhe në vitin 2010.

KQZ ka përcaktuar që koha e trajnimeve të zgjasë vetëm tre ditë. Edhe pse për dallim nga zgjedhjet e kaluara, në zgjedhjet e vitit 2010, ka pasur numër më të madh të komisionerëve në trajnime, ku kjo kohë sipas vlerësimeve të “Demokracisë në Veprim” ishte tejet e shkurtër dhe e pamjaftueshme për trajnime substanciale dhe cilësore. Kjo u dëshmuar edhe në praktikë, gjatë kryerjes së detyrave të tyre në procesin e numërimit të votave dhe në shpalljen e rezultateve. Probleme me trajnime janë paraqitur edhe në procesin e rivotimit më 9 dhe 23 janar, ku trajnimet janë bërë në ditët e fundit.

## REGJISTRIMI I PARTIVE POLITIKE

Sipas Rregullës për regjistrimin dhe veprimin e partive politike, Zyra për regjistrimin e partive politike dhe certifikim (“Zyra”) është përgjegjëse për regjistrimin dhe mirëmbajtjen e regjistrimit të partive politike. Gjithashtu, kjo bënë edhe certifikimin e të gjitha subjekteve politike, që do të përfshihen në fletëvotim dhe kufizimin e shpenzimeve të fushatave dhe dispozitave për deklarim financiar<sup>18</sup>.

Për zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 12 dhjetorit 2010, nuk ka pasur asnjë rast të refuzimit të certifikimit të asnjë subjekti politik nga ana e zyrës për regjistrimin e partive politike. KQZ është detyruar që të gjitha partive politike t’ju kërkojë plotësimin e kushteve shtesë në përputhje me Ligjin dhe rregullat zgjedhore.

<sup>18</sup> Neni 2 i Rregullës për regjistrimin dhe veprimin e partive politike

## LISTAT ZGJEDHORE

Lista Përfundimtare e Votuesve (LPV) e zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Kosovës 2010, bazohet në Ekstraktin e Regjistrimit Civil, i cili është përpiluar nga Agjencia për Prodhimin e Dokumenteve (APD), në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Gjithashtu, Lista e Votuesve jashtë Kosovës 2010, përmbante të gjithë votuesit me zotësi juridike të regjistruar në mënyrë të suksesshme. Numri i përgjithshëm i votuesve jashtë Kosovës ishte 1640. Në krahasim me zgjedhjet e kaluara, ishin 162 votues më pak, të cilët janë regjistruar për të votuar përmes postës.

Të gjithë votuesit kanë pasur mundësi që t'i kontaktojnë zyrtarët ekzekutivë komunalë (nga 10/11 – 16/11 2010). Gjithashtu, kanë pasur mundësi që të informohen se në cilën qendër të votimit janë caktuar, ose të kërkojnë ricaktim të qendrës së votimit, e cila është më të përshtatshme për ta.

Gjatë kësaj periudhe, 4000 votues i kanë vizituar Zyrat e KKZ-ve. Më pas 3200 votues kanë kërkuar ndërrimin e QV (91 kanë kërkuar direkt në zyrën e shërbimit të votuesve). Nga këto kërkesa janë refuzuar vetëm 328. Po ashtu, votuesit kanë pasur mundësi të konfirmojnë qendrën e tyre të votimit, përmes ueb faqes së KQZ-së. Gjatë kësaj periudhe këtë link e kanë vizituar rreth 10213 persona.

## PERIUDHA E KUNDËRSHTIMIT DHE KONFIRMIMIT

Periudha e kundërshtimit dhe e konfirmimit të listës së votuesve nga ana e votuesve, është përcaktuar nga KQZ-ja prej 22 deri më 26 nëntor 2010, ku u është mundësuar të gjithë votuesve që të sfidojnë LPV-në. Pas periudhës së kundërshtimit dhe konfirmimit, zyra e Shërbimit të Votuesve ka pranuar 4 vendime të gjykatave komunale. Prej tyre, dy vendime kanë urdhëruar largimin e 3 personave të vdekur nga Lista e Votuesve, ndërsa 2 vendime kanë vërtetuar kërkesën për ndërrimin e QV. Po ashtu, gjatë kësaj periudhe, nga Regjistri Civil janë larguar 14 persona të vdekur. Përkundër që KQZ-ja ka bërë një punë të mirë për pastrimin e listave të votuesve, ky problem në masë të madhe është ende i pranishëm.

## VOTIMI PËRMES POSTËS

KQZ ka përcaktuar afatin kohor për votuesit, përmes postës prej 5 deri më 16 nëntor 2010, në përputhje të plotë me rregullën Nr. 15 të KQZ për zgjedhjet e parakohshme dhe të jashtëzakonshme. Bazuar në informatat zyrtare të KQZ, njësia e shërbimit të votuesve brenda këtij institucioni, ka dërguar 2546 formularë dhe të gjitha materialet e tjera të nevojshme për informimin e votuesve të zgjedhjeve të kaluara. (Këta formularë shkuan në 26 shtete). Po ashtu, 900 formularë të tjerë për regjistrim, si dhe materiale të tjera informuese janë dërguar edhe në

45 pikat shpërndarëse në 24 shtete. Informatat e nevojshme dhe formulari janë publikuar në ueb faqen zyrtare të KQZ-së.

Deri në përfundim të periudhës së regjistrimit, kjo njësi ka pranuar 5015 aplikacione. Prej tyre janë aprovuar 1640 votues, ndërsa janë refuzuar 3228. Ndërsa 147 aplikacione kanë qenë të dyfishta. Numri i përgjithshëm i votuesve në listën e votuesve jashtë Kosovës ishte 1640.

Bazuar në numrin tejet të madh të qytetarëve të Kosovës që jetojnë jashtë vendit, kjo shifër e votuesve është më pak se simbolike. KQZ dhe institucionet e tjera shtetërore, duhet ta ndryshojnë qasjen, duke i koordinuar veprimet, në mënyrë që të gjithë qytetarëve t'u lehtësohen mundësitë e votimit, të cilët për arsye të ndryshme jetojnë jashtë Kosovës.

## EDUKIMI I VOTUESVE

Sa i përket edukimit të votuesve, KQZ ka lansuar një fushatë sensibilizuese, e cila ka zgjatur 25 ditë. Në te janë përfshirë mbi një mijë transmetime televizive. Ka pasur transmetime edhe në televizione lokale. Nëse nisemi nga fakti që numri i fletëvotime të pavlefshme, ka qenë dukshëm më i vogël, se në zgjedhjet e kaluara, mund të konsiderohet se kjo fushatë ka dhënë deri në një masë frytet e saj.

## FUSHATA ZGJEDHORE

Bazuar në Rregullën Zgjedhore të KQZ-së me nr. 15/2010, për zgjedhjet e jashtëzakonshme, si dhe për zgjedhjet e parakohshme, fushata zgjedhore ishte shkurtuar në vetëm dhjetë (10) ditë, ku përfundoi një (1) ditë para ditës së zgjedhjeve<sup>19</sup>.

Fryma e fushatës zgjedhore ishte relativisht e qetë. Fushata zgjedhore në tërësinë e saj është zhvilluar lirisht dhe pa ndonjë pengesë në të gjitha vendet, të cilat janë monitoruara nga vëzhguesit e “Demokracisë në Veprim”. Pati incidente sporadike (të izoluara), siç ishin në rastet në Prizren, më 2.12.2010, pastaj incidenti në fshatin Zhur gjatë kohës së mbajtjes së aktivitetit zgjedhor të AAK-së dhe Listës “Dr. Ibrahim Rugova”. Gjithashtu, janë regjistruar edhe dy incidente të ndara, të përmasave më të vogla në Mitrovicë: njëri gjatë tubimit të AKR-së dhe tjetri në Shipol të Mitrovicës.

Po ashtu, gjatë kësaj fushate elektorale u shënuan disa raste të shkeljes së Kodit të Etikës nga subjektet zgjedhore dhe kandidatët e tyre. Raste të tilla ishin: Dëmtimi i materialit propagandues nga ana e partive politike, përdorimi i resurseve publike. Pastaj u vërejt edhe prania e fëmijëve në shumë aktivitete të subjekteve politike. Tjetër shkelje ishte edhe vendosja e materialit propagandues në objekte publike. Shkelje ishin edhe veprimet e ndaluara nga shërbyesit civilë,

<sup>19</sup> Rregulla e KQZ-së për zgjedhjet e jashtëzakonshme dhe të parakohshme.

fjalori fyes dhe kërcënimet, e deri te mosparaqitja e kalendarit të aktiviteteve të subjekteve politike në KKZ.

Edhe pse ishte koha shumë e kufizuar për fushatë elektorale (vetëm 10 ditë), megjithatë, ranë në sy shpenzimet e mëdha të subjekteve politike gjatë fushatës elektorale, sidomos shpenzimet e partive të mëdha. “Demokracia në Veprim” inkurajoi të gjitha institucionet kompetente që të zbatojnë në përpikëri dispozitat ligjore, lidhur me verifikimin e burimeve financiare të fushatës elektorale.

## HESHTJA ZGJEDHORE

Me heshtje zgjedhore, nënkuptohet koha prej 24 orësh para fillimit të procesit të votimit, ku ndalohet çdo formë e propagandës zgjedhore. Në këto zgjedhje heshtja zgjedhore u respektua. Por, pati edhe raste, sidomos në ditën e votimit, ku jo vetëm komisionerët e subjekteve politike bënë propagandë në qendrat e votimit dhe të numërimit, por janë evidentuar edhe raste, kur persona të paautorizuar qëndronin në qendrat e votimit, duke propaganduar për subjektet e caktuara politike.

## VOTIMI 12 DHJETOR 2010

### Përgatitja e vendvotimeve

Duke u bazuar në raportimet e vëzhguesve të “Demokracisë në Veprim”, përgatitja e vendvotimeve (vv) në ditën e zgjedhjeve të 12 dhjetorit 2010, në pjesën më të madhe të tyre, (apo 84,9%) përgatitja kishte filluar në kohën e duhur midis orës 6:00 – 7:00. Megjithatë, në 10% të vv-ve evidentohen vonesa në aspektin e përgatitjes së vendvotimeve, ku në këto raste përgatitjet zhvilloheshin midis orës 7:00 – 8:00. Më së shumti vonesa për nga numri i vendvotimeve hasen në Komunën e Prizrenit - 49 sosh, pastaj në Komunën e Prishtinës - 25 dhe atë të Drenasit në 17 sosh. Po ashtu, të njëjtat vonesa në 14 vv hasen edhe në Komunën e Skenderajt dhe të Podujevës. Ky numër nëse krahasohet me numrin e përgjithshëm të vendvotimeve në këto komuna përbën 20% të atyre në Komunën e Skenderajt, gjegjësisht 13% të atyre në Komunën e Podujevës. Nga ana tjetër raportohen edhe për një vendvotim, në Komunën e Skenderajt, ku përgatitjet kishin filluar pas orës 8.00<sup>20</sup>.

	Fillimi i përgatitjeve të vendvotimit në kohën e paraparë	Vonesat	
		7:00 – 8:00	Pas orës 8:00
Komuna:	6:00 – 7:00	7:00 – 8:00	Pas orës 8:00
Prizren	155	49	

<sup>20</sup> Nga ana e vëzhguesve të “Demokracisë në Veprim” nuk raportohen raste të moshapjes së vendvotimeve, duke përjashtuar këtu vendvotimet në pjesën veriore të vendit, ku votimi ishte bërë në qendra mobile të votimit.

Prishtinë	195	25	
Drenas	42	17	
Skenderaj	55	14	1
Podujevë	93	14	
Malishevë	56	9	
Suharekë	73	7	
Pejë	115	7	
Vushtrri	83	7	
Dragash	47	6	

Tabela 1. Paraqitja e komunave ku hasen më së shumti vonesa në përgatitjen e vendvotimeve.

Vonesat në përgatitjen e vendvotimeve, në masë të caktuar kishin ndikuar edhe në hapjen me kohë të tyre. Hapja e vv para orës shtatë, raportohet të ketë ndodhur në 32,8% të të gjitha vv. Nga ana tjetër, në 63,8%, hapja ishte bërë me një vonesë, duke shtyrë kohën e hapjes nga ora 7:00 – 8:00<sup>21</sup>. Në dhjetë vv, prej të cilave tri në Komunën e Ferizajt dhe nga një në Komunën e Dragashit, të Gjilanit, të Mitrovicës, të Podujevës, të Prizrenit, të Suharekës dhe të Vushtrrisë raportohen vonesa në hapjen e tyre, të cilat zgjatën nga ora 8:00 – 10:00.




Figura 1, Paraqitja e orarit të kohës së hapjes së vendvotimeve.


Në rreth 7% të vendvotimeve, përgatitja e tyre, në aspektin e largimit të materialit propagandues zgjedhor në largësi prej 100 metrave larg vendvotimit nuk ishte respektuar<sup>22</sup>. Për nga numri, më së shumti raste të kësaj natyre të shkeljeve vërehen në Komunën e Prishtinës dhe të Prizrenit me nga shtatëmbëdhjetë vv. Kurse shprehur në përqindje prin Komuna e Istogut me 16% të vendvotimeve e pasuar nga Komuna e Skenderajt me 14% të vv-ve etj.

<sup>21</sup> Në bazë të formularëve të “Demokracisë në Veprim” nuk mund të caktohet saktë me minuta sa kanë zgjatur këto vonesa midis orës 7:00 deri 8:00.

<sup>22</sup> Në 11% të vendvotimeve vëzhguesit nuk janë përgjigjur në këtë pyetje për shkak të pamundësisë së identifikimit nëse ekzistonte material propagandistik apo jo.

Materialet e nevojshme zgjedhore brenda dhe jashtë vendvotimit, si: informatat se si duhet të votohet, lista e subjekteve politike, apo lista e kandidatëve brenda kabinës së votimit, ishin të vendosur në pjesën më të madhe të vendvotimeve. Raportohen vetëm 13 raste, ku mungonin këto materiale. Numri më i madh i të cilave gjenden në Komunën e Prizrenit gjithsej pesë, dy vendvotime në Komunën e Suharekës, si dhe nga një rast në Deçan, në Dragash, në Drenas, në Pejë, në Podujevë e në Prishtinë. Në këtë kontekst, më shqetësues është fakti i mungesës së Listës së Kandidatëve brenda kabinave ku votohet. Ky fenomen u has edhe në dhjetë vendvotime, prej të cilave katër ndodhen në Komunën e Suharekës, dy në Komunën e Prizrenit dhe nga një rast në Drenas, në Pejë, në Podujevë, në Prizren dhe në Vushtrri.

Nga materialet e tjera teknike, si: llamba ultravjollcë, lista e votuesve dhe të tjera evidentohen të kenë munguar në 10,7% të vendvotimeve. Përveç mungesës së këtyre materialeve, raportohen raste kur edhe pse të pranishme, materialet si llambat nuk kanë qenë plotësisht funksionale, për shkak të baterive të dobëta, apo spreji nuk ka qenë i një cilësie të duhur.



*Figura 2, Mungesa e materialeve të ndryshme si llambat ultravjollcë apo listat e votuesve e shprehur në përqindje për të gjitha vendvotimet.*

Sa i përket numrit të kabinave në vendvotim, në pjesën më të madhe të rasteve (apo në 83,1%), çdo vv kishte nga dy kabina, ku do të zhvillohej votimi. Në 2,7% të vv ishte e pranishme vetëm një kabinë, e në rastet më të këqija apo në 1,8% gjatë përgatitjeve, nuk ishte e pranishme asnjë kabinë në vendvotim.




Figura 3, Paraqitja në përqindje e numrit të kabinave në vendvotime.

Edhe pse procesi i votimit, kryesisht ishte zhvilluar në objekte shkollore anembanë vendit, jo të gjitha objektet siguronin një qasje adekuate për personat me nevoja të veçanta në vendvotim. Në më shumë se një të tretën e vendvotimeve, (apo në 34,2% ) nuk ishte siguruar një qasje e duhur për këtë kategori të popullatës, duke e bërë kështu të vështirë procesin e votimit për ata<sup>23</sup>.

Para se të vendosen shiritat e sigurisë në kuti, anëtarët e këshillit të vendvotimit (KVV), do të duhej t'u tregonin vëzhguesve të pranishëm në vendvotim që kjo kuti është e zbrazët. Në 18 vendvotime, ku votohej më 12 dhjetor 2010, drejtpërdrejt janë vendosur shiritat e sigurisë, pa u verifikuar nëse kutia është e zbrazët. Nga ana tjetër, në shtatë vendvotime, dy në Komunën e Kamenicës dhe nga një në komunat: Gjakovë, Gjilan, Drenas, Pejë dhe Prizren, anëtarët e KVV-ve nuk kishin mbyllur fare kutitë me shirita të sigurisë. Këtyre komunave u shtohen edhe tre vendvotime të tjera, duke bërë gjithsej 10 numrin e vendvotimeve, ku numrat serikë të shiritave të sigurisë nuk ishin regjistruar në librin e duhur.

Procesi i votimit paraqitet të jetë mjaft transparent për vetë faktin se përveç misionit monitorues të “Demokracisë në Veprim”, procesi në masë të madhe ishte monitoruar edhe nga ana e vëzhguesve të subjekteve politike, vëzhguesve të OJQ-ve të tjera, vëzhguesve ndërkombëtarë dhe mediave. Nëse krahasohen subjektet politike, numrin më të madh të vëzhguesve e kanë pasur subjektet politike: Partia Demokratike e Kosovës dhe Lidhja Demokratike e Kosovës, të cilat mbulonin mbi 90% të vendvotimeve me vëzhguesit e tyre. Subjekti politik, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, ishte e treta për nga numri i vëzhguesve të angazhuar, ku përfshinte 79,8% të vendvotimeve. Lëvizja “Vetëvendosje!” kishte vëzhgues në 77,3% të vendvotimeve, AKR

<sup>23</sup> Vëzhguesit e “Demokracisë në Veprim” nuk ishin përgjigjur në këtë pyetje në 20,8% të rasteve.



në 66,7%, ndërsa më pak vëzhgues kishin LDD dhe FER nën 30%. Po ashtu, procesi i votimit ishte monitoruar edhe nga vëzhgues ndërkombëtarë, si dhe nga mediat, të cilat mbulonin 13% të vendvotimeve.




Figura 4, Paraqitja e përqindjes së vëzhguesve të procesit zgjedhor.

### Sigurimi i fshehtësisë së votës

Parimi për votim të fshehtë në një numër të vendvotimeve nuk ishte respektuar, sepse vendosja e kabinave ishte bërë në atë mënyrë që nuk siguronte fshehtësinë e votës. Si dukuri haset në Komunën e Podujevës në tri vendvotime (vv), pastaj në atë të Obiliqit, të Pejës e të Prishtinës me nga dy vv dhe nga një në Komunën e Ferizajt, të Fushë Kosovës dhe të Kamenicës.

### Anëtarët e këshillit të vendvotimit

Në vendvotimet e vëzhguara nga ana e “Demokracisë në Veprim”, kanë qenë të angazhuar gjithsej 15 465 anëtarë të Këshillave të Vendvotimit (KVV) apo në mesatare 7 anëtarë për vendvotim. Përkundër këtij fakti, në 46 vendvotime raportohen raste kur ishin të pranishëm më pak se 3 anëtarë të KVV-ve. Sa i përket aspektit gjinor, nga ky numër i përgjithshëm i anëtarëve, 12 192 anëtarë apo 78,8% i përkasin gjinisë mashkullore, kurse vetëm 2978 apo 19,2% asaj femërore.



*Figura 5, Paraqitja në përqindje e përfaqësimit gjinor të anëtarëve të KVV-ve.*

Përfaqësimi i femrave, si pjesë e anëtarëve të KVV-ve dallon varësisht nga komuna. Kështu përfaqësim mjaft i mirë vërehet në Komunën e Ranillugut, ku 42,8% e anëtarëve ishin femra, pasuar nga Komuna e Prishtinës me 33,1% dhe Pejës e Fushë Kosovës me rreth 27% të anëtarëve të KVV të gjinisë femërore. Nga ana tjetër, më së paku femra, si pjesë e anëtarëve të KVV-ve shënohen në Komunën e Dragashit me 2,9%, kurse edhe më e keqe duket situata në Komunën e Mamushës, ku të gjithë 19 anëtarët e KVV-ve ishin meshkuj.

### **Procesi i votimit**

Në formularët e vëzhguesve të “Demokracisë në Veprim”, të cilët kishin monitoruar procesin e votimit, hasen disa shkelje, të cilat janë kategorizuar në bazë të procedurave përkatëse të votimit. Anëtarët e KVV-ve në masë të madhe kishin respektuar procedurat e votimit. Së pari, duke filluar nga procedurat e kontrollimit të ngjyrës në gisht, pastaj kontrollimin e dokumenteve të identifikimit, detyrimi i nënshkrimit të votuesve në listë, vulosja e fletëvotimeve para se t’u dorëzohen votuesve, spërkatja e ngjyrës në gisht, si dhe vendosja në zarfë e fletëvotimeve të “refuzuara” nga ana e vëzhguesve.

Kontrollimi i ngjyrës në gisht, si procedurë gjithmonë ishte respektuar nga ana e komisionerëve të vendvotimit (në 94% të vv-ve), kurse në shtatë vendvotime janë raportuar raste kur ngjyra rrallë kontrollohej nga komisionerët. Këto vendvotime ishin: dy në komunën e Gjilanit dhe nga një në Ferizaj, në Drenas, në Malishevë, në Shtërpçë dhe në Vushtrri. Përqindje të ngjashme të respektimit të procedurave nga ana e komisionerëve shënohen edhe në aspektin e kontrollimit të dokumenteve dhe nënshkrimit të votuesve në listë, apo të vulosjes së fletëvotimeve në rreth 96% të rasteve gjithmonë realizohej.

Procedurat e votimit	Përqindja e vendvotimeve ku gjithmonë respektohet procedura përkatëse
Kontrollimi i ngjyrës në gisht	94%
Kontrollimi i duhur i dokumenteve të identifikimit	96,7%
Nënshkrimi i votuesve në listën e votuesve	96,6%
Vulosja e fletëvotimeve para se t'i dorëzohen votuesit	96%
Spërkatja e ngjyrës në gisht	95,2%

*Tabela 2, Paraqitja e përqindjes së procedurave të votimit nga ana e anëtarëve të KVV-ve.*

Nga raportimet e vëzhguesve të DV, disa nga shkeljet e procedurave të votimit ishin bërë edhe nga ana e votuesve. Kështu, shënohen raste në 18 vendvotime, ku votuesit kishin refuzuar që t'u spërkatej gishti para se të votonin. Shkelja e tillë paraqitet e shpërndarë si dukuri në komuna të ndryshme, duke mos shfaqur ndonjë fokusim të dukshëm në ndonjë rajon të caktuar. Po ashtu, evidentohen gjithsej 175 vendvotime, apo 8,1% të tyre, ku votuesit kishin votuar publikisht jashtë kabinave të vendvotimit. Më së shpeshti këto raste raportohen të kenë ndodhur në Komunën e Gjilanit, gjithsej në 16 vendvotime, pastaj në komunën e Lipjanit 15 dhe në 14 vv në Komunën e Prishtinës, të Mitrovicës dhe të Prizrenit. Po ashtu, mjaft shpesh si shkelje shfaqet në Komunën e Vitisë në gjithsej 12 vendvotime, apo në 20,6% të vv-ve të kësaj komune.

Çështjet	Numri i vendvotimeve ku haset çështja
Refuzimi për spërkatjen e gishtit nga ana e votuesve	18
Votimet Publike	175
I njëjti person ndihmon më tepër se një votues me nevoja të veçanta	570
Votimet familjare	1559

*Tabela 3, Disa nga çështjet ku votuesit përfshihen në shkelje të rregullave të votimit.*


Dukuria e asistimit për shumë persona që kanë nevojë për votim e që kërkojnë ndihmën e dikuj tjetër, shpeshherë këtyre personave në ndihmë u vinte i njëjti person. Kjo dukuri u vërejt diku në 27,5% të vendvotimeve. Edhe pse nuk paraqet një shkelje të drejtpërdrejtë të komisionerëve, ata do të duhej të ishin përgjegjës në parandalimin e këtij fenomeni. Më së shpeshti kjo dukuri u shfaq në Komunën e Prishtinës në 48 vendvotime dhe atë të Prizrenit në 42 sosh. Vlen të ceket edhe paraqitja mjaft e theksuar e kësaj dukurie në Komunën e Drenasit, ku shfaqet në 57,6% të vendvotimeve dhe në atë të Skenderajt në 47,1% të tyre.

### **Votimet familjare**

Një fenomen, i cili e cenon të drejtën e votimit të fshehtë dhe i cili po shfaqet gati në të gjitha zgjedhjet e organizuara deri më tani është edhe i ashtuquajturit votim familjar. Kjo dukuri kur disa persona, nën pretekstin e afërsisë së tyre familjare, votojnë në të njëjtën kohë në një kabinë të

votimit, duke pamundësuar kështu ruajtjen e fshehtësisë së votës. Si dukuri gjatë zgjedhjeve të 12 dhjetorit raportohet të jetë shfaqur deri në 72% të vendvotimeve, pa ndonjë përqendrim të theksuar në ndonjë komunë të veçantë. Natyrisht më së shumti raste për nga numri raportohen në Komunën e Prishtinës, për shkak të numrit më të madh të vendvotimeve në këtë komunë (në gjithsej 169 sosh). Po ashtu, në Komunën e Skenderajt në 94,2% të vendvotimeve raportohet të jenë hasur raste të votimeve familjare.

Po ashtu, asistimi i votuesve nga ana e vëzhguesve raportohet të jetë paraqitur në 18% të vendvotimeve. Si dukuri më së shumti paraqitet në Komunën e Prizrenit në 39 vendvotime, pasuar nga ajo e Prishtinës me 37 prej tyre.



*Figura 6, paraqitja në përqindje e vendvotimeve ku hasen raste në të cilat votuesit shoqërohen nga persona tjerë në kabinën e votimit.*

### **Ambienti i Votimit**

Procesi i votimit, në zgjedhjet parlamentare të 12 dhjetorit 2010, ishte zhvilluar në një ambient të qetë me një numër të caktuar të incidenteve të evidentuara. Në 16 vendvotime, tre në Komunën e Gjakovës, nga dy në Komunën e Obiliqit, Mitrovicës, Pejës dhe nga një rast në Komunën e Suharekës, Hanit të Elezit, Klinës, Vitisë, Drenasit, Deçanit dhe Malishevës u evidentuan disa incidente, të cilat fatmirësisht nuk përcillen me dhunë apo keqtrajttime. Arsye e shkaktimit të këtyre incidenteve raportohen të kenë qenë tensionet dhe mospajtimet midis vëzhguesve partiakë dhe anëtarëve të KVV-ve. Pastaj refuzimi nga ana e votuesit për spërkatje të gishtit, presioni mbi vëzhguesit e DV apo ndërprerje të votimit për shkak të mungesës së energjisë elektrike.

Në 48 vendvotime, apo më pak se 1% të tyre raportohen raste të pengimit të procesit të votimit. Në këtë aspekt, më së shumti raste, gjithsej gjashtë raportohen të kenë ndodhur në Komunën e Drenasit.

Atmosfera e qetë në vendvotim nuk ishte ruajtur deri në përfundim të procesit në 100 vendvotime. Kjo ishte kryesisht për shkak të propagandës politike brenda vendvotimit, për shkak të tollovide të shkaktuara në korridore, apo tensioneve midis vëzhguesve dhe anëtarëve të KVV-ve. Propaganda në vendvotim haset në 32 vv, prej të cilave më së shpeshti në 6 vendvotime në Komunën e Gjilanit, pastaj 4 në Komunën e Pejës dhe me nga tre prej tyre në Komunën e Klinës dhe Vitisë. Stërmbushja e vendvotimeve me votues raportohet të jetë evidentuar në rreth 30% të vv-ve, me dominim në Komunën e Prishtinës në 68 vendvotime, si dhe në Komunën e Podujevës në 48 sosh. Po ashtu, ndër faktorët që ndikuan në prishjen e procesit të qetë të votimit, ishin edhe tentimet për të votuar më shumë se një herë, apo për të asistuar më shumë se një herë gjatë votimit, si dhe ndërprerja e kohëpaskohshme e energjisë elektrike.

### **Procesi i numërimit**

Duke u bazuar në strategjinë e monitorimit të zgjedhjeve të 12 dhjetorit 2010, vëzhguesit që kishin vëzhguar ditën e zgjedhjeve, gjatë procesit të votimit, ishin zëvendësuar me vëzhgues të "Demokracisë në Veprim", të cilët enkas do të monitoronin procesin e numërimit të votave.

#### **- Koha e përfundimit të votimit**

Në mbi gjysmën e vendvotimeve (vv), procesi i votimit kishte përfunduar midis orës 19:00 – 20.00, kurse në 36.3% të vv-ve ato ishin mbyllur prej orës 18:00 – 19:00<sup>24</sup>. Vetëm në 11 vendvotime vonesat kishin zgjatur deri në ora 21.00, dhe në 16 tjera raportohet për vonesa edhe pas orës 21.00. Përkundër këtij fakti, 85,5% të votuesve, të cilët kishin pritur në radhë për të votuar pasi që ishte mbyllur vendvotimi ishin lejuar që të votojnë, kurse vetëm në 8 prej tyre nuk ishte lejuar votimi edhe pse kishte votues që pritnin në radhë për të votuar. Këto raste u evidentuan në Komunën e Pejës dhe të Gjakovës me nga 3 raste të raportuara.

---

<sup>24</sup> Dallimi i shprehur në minuta midis orës 18.00 – 19.00 dhe asaj 19.00-20.00 nuk mund të vlerësohet nga format e plotësuara të vëzhguesve.




Figura 7, Paraqitja në përqindje e kohës së përfundimit të votimit në vendvotimet e vëzhguara nga DnV.

#### - Transparenca e Numërimit

Si procesi i votimit, po ashtu edhe ai i numërimit të votave kishin qenë mjaft transparent pasi që ishin monitoruar nga vëzhgues të subjekteve politike dhe ata të OJQ-ve. Përveç rrjetit të OJQ-ve “Demokracia në Veprim”, i cili mbulonte të gjitha vendvotimet, edhe subjektet politike mbulonin një pjesë mjaft të madhe të tyre. Kështu 92% e vendvotimeve kishin qenë të mbuluara nga vëzhguesit e dy subjekteve më të mëdha politike: Partia Demokratike e Kosovës dhe Lidhja Demokratike e Kosovës. Më pas, për nga numri i vëzhguesve renditen Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës me 87,3% të vendvotimeve të mbuluara, Aleanca Kosova e Re me 77,7%, Vetëvendosje me 69% dhe LDD me 48.4%. Subjekti politik me më së paku vëzhgues ishte FER me të 33,8% të v-v-ve.

Në 5 vendvotime ishte evidentuar prezenca e personave të paautorizuar, të cilët kishin qëndruar brenda vendvotimit gjatë procesit të numërimit. Këto raste ishin raportuar nga një në Komunën e Obiliqit, Prishtinës, Prizrenit, Mitrovicës dhe atë të Vitisë. Shikimi i mirë në procedurat e numërimit ishte siguruar në shumicën e vendvotimeve, përveç në 22 syresh, ku vëzhguesit nuk kishin pasur mundësinë që më së miri të monitorojnë procesin e numërimit, për shkak të pozicionit ku ishin vendosur nga ana e komisionarëve të vv.

#### - Procedurat e Numërimit

Nga problemet që ishin raportuar edhe në vitet e kaluara nga “Demokracia në Veprim”<sup>25</sup>, ku të cilat u përsëriten edhe në zgjedhjet e 12 dhjetorit 2010, janë ato të mosnumërimit dhe mosregjistrimit të fletëvotimeve të papërdorura. Kjo dukuri u shfaq në 108 vendvotime në Kosovë, kurse dukuria e mosnumërimit dhe mosregjistrimit të fletëvotimeve të prishura e të

<sup>25</sup> Demokracia në Veprim - Raporti I Zgjedhjeve Komunale 2009

refuzuara në 121 vendvotime. Vlen të theksohet se në 81 vendvotimeve, të dy këto shkelje të procedurave shfaqen paralelisht. Ato raportohen kryesisht në Komunën e Prishtinës në 12 vv, atë të Pejës në 10 dhe të Prizrenit në 8 vv<sup>26</sup>.

Procedurat e tjera të numërimit, si kontrollimi i shiritave të sigurisë ishin respektuar gati në të gjitha vendvotimet (apo 99,5%) dhe në shumicën e rasteve, (apo 98,4%) ato kishin qenë të paprekura.

Raportohen vetëm 6 vendvotime, apo më pak se 1%, të cilat nuk kishin bërë numërimin dhe regjistrimin e nënshkrimeve në listën e votuesve. Këto vendvotime ishin nga një në Komunën e Prishtinës, Prizrenit, Pejës, Kamenicës, Gjakovës dhe Vitisë.

Vëzhguesit e “Demokracisë në Veprim”, raportojnë për mosvendosje anash të materialit të votimit si: fletëvotimeve të papërdorura, të prishura apo të refuzuara, apo listave të votuesve, markerëve, lapsave, gjatë numërimit. Këto dukuri u shfaqën në 16 vendvotime dhe atë më së shpeshti në Prizren në 3 vendvotime, dhe Kamenicë e Gjilani me nga dy vv.

Procedurat e numërimit të votave	Përqindja e vendvotimeve ku respektohet procedura përkatëse
Kontrollimi i shiritave sigures para hapjes së kutisë së votimit	99.5%
Konstatimi që shiritat sigures janë të paprekur	98.4%
Numërimi dhe regjistrimi i nënshkrimeve në listën e votuesve	99.7%
Numërimi dhe regjistrimi i fletëvotimeve të papërdorura	94.3%
Numërimi dhe regjistrimi i fletëvotimeve të prishura dhe të refuzuara	95,2%
Verifikimi dhe regjistrimi i shiritave sigures	99.4%
Vendosja anash e materialeve të votimit (fletëvotimet e papërdorura, të prishura, të refuzuara, vulat, listat e votuesve, markezët, lapsat)	99.1%
Vendosja anash e fletëvotimeve të pavlefshme	99.6%

*Tabela 4, paraqitja e respektimit të procedurave të numërimit në vendvotime.*

Vendosja anash e fletëvotimeve të pavlefshme gjatë procesit të numërimit nuk ishte respektuar vetëm në shtatë vendvotime. Po ashtu, në shtatë vv votat e numëruara nuk i kishin futur në thesin plastik transparent. Nga vendvotimet e lartpërmendura raportohen dy: një në Komunën e Kamenicës dhe tjetra në atë të Prizrenit, në të cilat evidentohen të dy shkeljet paralelisht.

<sup>26</sup> Ky fenomen nuk fokusohet vetëm në komuna të caktuara, por paraqitet si l shpërndarë, komunat e cekura janë paraqitur si vende ky më së shpeshti takohen këto dy shkelje.

Si pjesë e procesit të numërimit (75,1%) të vendvotimeve të dyfishta, komisionerët kishin bërë numërimin e zarfeve të hapura ndaras dhe shënimin e tyre si të pavlefshme, kurse vetëm në 71 vv nuk ishte vepruar ashtu.

Numërimi i votave në 80,6% të vendvotimeve kishte përfunduar para mesnate, kurse zgjatja e procesit nga mesnata deri në orën 6:00 ishte paraqitur në 15.8% të vv-ve.

#### - Ankesat rreth numërimit

Vendimet e anëtarëve të KVV-së mbi fletëvotimet që janë të dyshimta në të shumtën e rasteve vlerësohet të kenë qenë të drejta. Raportohen 53 vendvotime, apo 2.6% në të cilat vëzhguesit e “Demokracisë në Veprim” vlerësojnë që këto vendime rrallë janë të drejta.

Në aspektin e mospajtimeve rreth vendimeve lidhur me fletëvotimet e dyshimta, në 89.3% të rasteve ku kishte mospajtime, ato ishin shënuar në librin adekuat. Rastet kur ato mospajtime janë shënuar rrallë në librin adekuat paraqiten në 61 vendvotime<sup>27</sup>.

Pas përfundimit të procesit të numërimit në gati 1% të vendvotimeve, apo më saktësisht në 18 vv, ishin kundërshtuar rezultatet nga ana e ndonjë përfaqësuesi apo vëzhguesi. Kryesisht natyra e ankesave dhe pretendimet e tyre ishin që disa vota të dyshimta të shpallen të pavlefshme. Pastaj ankesa për numërimin e gabuar të votave dhe kërkesat për rinumërim në vendvotim, mostransparenca gjatë numërimit të votave të kandidatëve për deputetë, ankesa për lëvizjen e vëzhguesve dhe hyrje-daljet e tyre nga vendvotimi.

#### Vlerësimi i procesit të numërimit nga ana e vëzhguesve

Në bazë të vlerësimit të vëzhguesve të procesit të numërimit, raportohet për një numër të caktuar të parregullsive gjatë këtij procesi, të cilat në masë të caktuar kanë ndikuar në rezultatin final. Nga raportimet e vëzhguesve të “Demokracisë në Veprim”, më së shumti parregullsi evidentohen në rastet ku fletëvotimet në kuti tejkalonin numrin e të nënshkruarve në regjistrin e votuesve në Komunën e Skenderajt dhe në atë të Drenasit. Po ashtu, raportohet për raste të falsifikimit të nënshkrimeve në Listën e Përfundimtare të Votuesve (ku një person ka nënshkruar për disa të tjerë). Nëse llogaritet koha e votimit në këto dy komuna ku raportohen parregullsitë, atëherë del që koha e procesit të votimit të një votuesi ka qenë vetëm 1.35 minuta, ndërkohë që mesatarja e nevojshme e procesit të votimit është vlerësuar se do të duhej të ishte 5-7 minuta. Janë identifikuar raste të daljes së 100% të gjithë votuesve të regjistruar në Listën e Votuesve. Gjithashtu, janë evidentuar rreth 27 vendvotime në Drenas, ku përqindja e daljes në votime ka qenë 90% të votuesve të regjistruar, ndërsa në Skenderaj gati të gjitha vendvotimet e kanë kaluar këtë shifër. Janë identifikuar disa raste ku numri daljes së votuesve për të votuar ka qenë në shuma të plota si p.sh (300, 500, 400 etj). Parregullsi të tjera të shënuara në raportet e vëzhguesve

<sup>27</sup> 55.4% të vëzhguesve nuk janë përgjigjur në këtë pyetje pasi që supozohet që në vendvotimet ku ata kanë vëzhguar nuk janë vërejtur mospajtime të tilla.



janë edhe mospublikimi i rezultateve në derën e vendvotimit nga një vv në Komunën e Mitrovicës, Ferizajt, Prizrenit, Fushë Kosovës apo të Gjilanit. Po ashtu, parregullsi shfaqen edhe nga ana e vëzhguesve të partive politike, në rastet kur ata kryejnë trysni në komisionarët e vendvotimit për numërimin më të shpejtë të votave, si dhe në rastet e hyrje-daljes së tyre nga vendvotimi gjatë numërimit të fletëvotimeve.

### **Vëzhgimi i transportit të kutive të votimit**

Përveç monitorimit të procesit të numërimit dhe atij të votimit të 12 dhjetorit 2010, vëzhguesit e “Demokracisë në Veprim” kishin monitoruar edhe procesin e grumbullimit të kutive të votimit nga qendrat e votimit në pjesën e grumbullimit në Komisionet Komunale Zgjedhore (KKZ). Po ashtu kishin monitoruar edhe transportin e këtyre kutive deri në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) në Fushë Kosovë. Përveç shënimit të kohës së arritjes së kutive në KKZ, po ashtu në fokus të monitorimit ishte edhe shënimi i kutive me njollë të zezë apo vendosja e tyre në karantinë. Pas arritjes së gjitha kutive në Komisionet Komunale Zgjedhore, monitoruesit e DV me mjetet e tyre të transportit ishin nisur pas konvojit, i cili këto kuti do t’i transportonte deri në QNR në Fushë Kosovë. Gjatë tërë rrugës ishte bërë përcjellja e konvojit, dhe po ashtu ishte shënuar koha e arritjes së tij në destinacion, në QNR – Fushë Kosovë. Edhe pse ishin planifikuar që të monitorohen të gjitha - 37 komunat e Kosovës, Demokracia në Veprim kishte monitoruar gjithsej 32 syresh, për shkak se tri komunat në veriun e Kosovës (Zveçan, Leposaviç dhe Zubin Potok) nuk ishin monitoruar për shkaqe të sigurisë. Po ashtu, kutitë nga Komuna e Vitisë dhe e Rahovecit nuk ishin monitoruar, pasi që zyrtarët e Komisioneve Komunale Zgjedhore nuk kishin lejuar qëndrimin e monitoruesit të DV në hapësirat e Komisionit Komunal Zgjedhor, ku grumbulloheshin kutitë me arsyetimin e mungesës së hapësirës për qëndrimin. Raportimet nga vëzhguesit e Demokracisë në Veprim, lidhur me monitorimin e transportit të kutive të votimit, nuk japin ndonjë informatë për vonesa apo ndalesa të konvojit gjatë rrugës deri në QNR. Raportimet lidhur me kutitë që kishin njollën e zezë, janë nga dhjetë vendvotime, me ç’rast komisionarët gabimisht i kishin futur të gjitha materialet, përfshirë edhe librat e votuesve në kuti apo për shkak se ishin vendosur shiritat e sigurisë gabimisht.

### **RIVOTIMI I 9 JANARIT 2011**

Pas vendimeve të marra nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), lidhur me ankesat e subjekteve politike dhe organizatave të shoqërisë civile për manipulim të procesit zgjedhor të 12 dhjetorit 2010, Komisioni Qendror Zgjedhor mori vendim për shpalljen e rivotimit në tri komuna dhe dy qendra të votimit më 9 janar 2011. Kështu, në Komunën e Skenderajt, Drenasit dhe Deçanit u rivotua, kurse në Komunën e Malishevës dhe atë të Lipjanit u votua vetëm në një qendër të votimit - në Llashkadrenoc të Malishevës, si dhe një qendër e votimit në Shalë të

Lipjanit. Rivotimi u organizua në gjithsej 185 vendvotime, të cilat ishin të monitoruara nga ana e Demokracisë në Veprim<sup>28</sup>.

### **Përgatitja e vendvotimeve**

Përgatitja e vendvotimeve gjatë procesit të rivotimit të 9 janarit 2011 në 80,5% të vendvotimeve ishte bërë midis orës 6:00 – 7:00. Në këtë proces ishin të angazhuar gjithsej 1335 anëtarë të ëshillave të endvotimeve (KVV-ve), me një mesatare prej shtatë (7) anëtarëve për vv. Sa i përket aspektit gjinor, nga këta 1335 anëtarë të KVV-ve, 1091 apo 81,7% ishin meshkuj dhe vetëm 219, apo 16,4% femra, çka përsëri paraqet një përfaqësim jo të kënaqshëm gjinor.

Edhe gjatë procesit të rivotimit paraqiten raste të parregullsive, të cilat janë dukshëm më minore krahasuar me parregullsitë që u evidentuan gjatë zgjedhjeve të 12 dhjetorit 2010.

Informatat lidhur me mënyrën si duhet të votohet, lista e subjekteve politike, si dhe lista e kandidatëve brenda kabinës nuk ishin vendosur vetëm në një vendvotim në Komunën e Skenderajt. Mungesave e materialeve tjera, si llamba ultravjollcë, lista e votuesve, raportohen të kenë munguar gjatë përgatitjeve të vendvotimeve në 4 vv në Komunën e Skenderajt, dy në atë të Drenasit dhe në një në Komunën e Deçanit, që gjithsej përbëjnë 3,7% të vendvotimeve ku u rivotua me 9 janar. Numri mesatar i kabinave ishte dy për një vendvotim, raportohen vetëm 5 raste ku në vendvotim ishte e pranishme vetëm një kabinë. Nga ana tjetër, evidentohen vetëm dy raste, njëri në një vv në Komunën e Skenderajt dhe tjetri në një vv të Drenasit, ku kabinat e votimit nuk siguronin fshehtësinë e votës.

Procedurat, si tregimi i kutisë së zbrazët para votimit, mbyllja e kutisë me shirita të sigurisë, si dhe regjistrimi i numrave serikë në librin e duhur ishin respektuar në të gjitha vendvotimet.

Procesi përveç monitorimit nga ana e Demokracisë në Veprim, ishte monitoruar nga vëzhgues të subjekteve politike, vëzhgues të organizatave të shoqërisë civile si dhe vëzhgues ndërkombëtarë dhe media. Vërehet një prani më e shtuar e vëzhguesve ndërkombëtar të cilët mbulonin mbi gjysmën e vendvotimeve, gjegjësisht 54,3% të vendvotimeve.

### **Votimi**

Hapja e vendvotimeve në 28,1% të vendvotimeve ishte bërë para orës 7:00, kurse pjesa tjetër e vendvotimeve evidentohet të jenë hapur prej orës 7:00 deri në ora 8:00. Vërehet se procedurat e votimit, si: kontrollimi i ngjyrës, kontrollimi i dokumenteve të identifikimit, nënshkrimi i votuesve, vulosja e fletëvotimeve, si dhe spërkatja e ngjyrës në gisht u respektuan në masë të madhe nga komisionarët. Evidentohet vetëm një vendvotim në Komunën e Drenasit ku këto procedura nuk u

---

<sup>28</sup> Në bazë të Strategjisë së Monitorimit të Rivotimit të 9 janarit 2011, Demokracia në Veprim në këto komuna kishte të vendosur dy pale të vëzhguesve të cilët qëndronin në vendvotim gjatë tërë kohës. Njëra palë e vëzhguesve ishin vëzhgues lokalë, kurse tjetra ishin vëzhgues nga komuna të ndryshme të Kosovës, të cilit ishin dërguar për monitorim të rivotimit të 9 janarit 2011.

respektuan plotësisht . Prania e më shumë personave njëkohësisht në kabinën e votimit, apo i a. q. votim familjar përsëri evidentohet në një numër të madh të vendvotimeve apo në 79,3% prej tyre.





Figura 8, Paraqitja në përqindje e kohës së hapjes së vendvotimeve gjatë rivotimit të 9 janarit 2011.

### Ambienti i votimit

Ambienti i votimit, gjatë procesit të rivotimit në 9 janar 2011 paraqitet kryesisht i qetë, edhe pse evidentohen raste të prishjes së kësaj atmosfere të qetë në vendvotim. Prosesi i votimit për shkaqe të ndryshme ishte penguar në gjashtë vendvotime, nga dy vendvotime në secilën komunë ku u mbajt rivotimi. Në komunën e Drenasit në katër vendvotime, po ashtu haset prishje e atmosferës së qetë të votimit kryesisht për shkak të ndërprerjes së energjisë elektrike apo tentimeve për të votuar më shumë se një herë.

Nga vëzhguesit e “Demokracisë në Veprim” raportohen katër vendvotime, ku në KVV nuk kishin qenë të pranishëm së paku tre anëtarë, duke vështirësuar kështu votimin. Raste të tilla raportohen në tre vendvotime në Komunën e Skenderajt dhe një në Komunën e Drenasit.

Incidentet po ashtu e përcollën edhe këtë proces të rivotimit. Më së shumti incidente janë raportuar në Komunën e Skenderajt, gjithsej në 11 vendvotime, apo në 15,7% të tyre në këtë komunë, si dhe në 3 vv në Komunën e Drenasit dhe në një vendvotim në Komunën e Deçanit. Shkaqet e këtyre incidenteve ishin të njëjtat me ato të prishjes së atmosferës së qetë, duke i shtuar këtyre edhe presionin mbi vëzhguesit e Demokracisë në Veprim dhe pengimin në monitorimin e tyre të lirë, gjë që rezultoi me tërheqjen e vëzhguesve nga dy vendvotime në Komunën e Drenasit pasi që ata nuk ndjeheshin të sigurt.



*Figura 9, Paraqitja në përqindje e raportimit të incidenteve në vendvotim për secilën komunë ku u organizua rivotimi i 9 janarit 2011*

Procesi i rivotimit u përcoll me parregullsi nga të cilat hasen raste kur një person asiston deri në dhjetë votues të tjerë në Komunën e Skenderajt, pastaj raste të votimeve të shumëfishta, si në Komunën e Skenderajt, po ashtu edhe në atë të Drenasit. Evidentohet edhe raste të rumbullakimit të kandidatëve të caktuar në listën e kandidatëve, apo edhe votimi pa dokumente identifikimi. Raportohet edhe për ndërprerje të energjisë elektrike, si dhe ndonjëherë votimi me qirinj apo llamba dore. Pati edhe votime familjare, ku këto fenomene evidentohen në të tri komunat, ku u organizuan këto zgjedhje.

### **Procesi i numërimit të votave**

Procesi i votimi në 33,3% të vendvotimeve kishte përfunduar midis orës 18:00-19:00, kurse pjesa më e madhe e vendvotimeve apo 64,8% të tyre këtë proces e kishin përfunduar diku midis orës 19:00 dhe 20:00.




Figura 10, Paraqitja në përqindje kohës së përfundimit të votimi.

Numërimi i votave kishte filluar menjëherë pas mbylljes së vendvotimeve. Në 95,9% të tyre numërimi evidentohet të ketë filluar nga ora 19:00 – 20:00, kurse vonesa hasen në 4,1% të vendvotimeve apo në 7 vv, prej të cilave gjashtë në Komunën e Skenderajt dhe një në Komunën e Deçanit.

Si procesi i votimit, ashtu edhe procesi i numërimit, përveç vëzhguesve të Demokracisë në Veprim kishte qenë i monitoruar edhe nga vëzhguesit e subjekteve politike, ata të organizatave të shoqërisë civile, vëzhgues ndërkombëtarë dhe nga mediat.<sup>29</sup>

Shikimi i mirë në procedura të numërimit kryesisht ishte siguruar për vëzhguesit, përveç në dy vendvotime në Komunën e Drenasit, ku ky proces nuk ishte i mundshëm.

Edhe pse procedurat e numërimit gjatë rivotimit të 9 janarit 2011 kryesisht ishin respektuar nga ana e komisionerëve. Por, pati raste të rralla të shkeljeve të procedurave, siç është rasti i mosnumërimit të fletëvotimeve të papërdorura në rreth 3% të vendvotimeve apo mosnumërimi i fletëvotimeve të prishura apo të refuzuara në rreth 5% të tyre.

Procesi i numërimit në pjesën më të madhe të vendvotimeve apo në 82% të tyre kishte përfunduar qysh para mesnate, duke lënë kështu një numër të vogël të vendvotimeve, ku procesi kishte vazhduar edhe pas mesnate.

<sup>29</sup> Demokracia në Veprim kishte të angazhuar nga dy vëzhgues në një vendvotim, dhe të dy vëzhguesit kanë qëndruar në vendvotim që nga hapja e vendvotimeve deri në numërimin e votive dhe shpalljen e rezultateve për atë vendvotim.

Në bazë të vlerësimeve të vëzhguesve në pjesën më të madhe të vendotimeve apo në 81,3% të tyre, numërimi kishte funksionuar normal dhe pa probleme. Kurse në pjesën tjetër të vendotimeve hasen parregullsi, ku në një masë kanë ndikuar në rezultatin përfundimtar.




Figura 11, Paraqitja në përqindje e vlerësimit të vëzhguesve mbi procesin e numërimit.

Vërejtjet më të mëdha të cilat paraqiten në këtë proces, janë ato lidhur me mungesën e energjisë elektrike dhe mundësinë për të manipuluar me vota. Pastaj rrumbullakimi nga ana e komisionerëve i fletëvotimeve, të cilat nuk i kishin 5 kandidatët e rrumbullakuar, apo tentimi që votat e pavlefshme -të zbrazëta, të bëhen të vlefshme, duke i rrumbullakuar ato. Hasen edhe raste kur nënshkrimet, në listën e votuesve nuk përputhen me numrin e votave, apo rastet e presionit mbi vëzhguesit e “Demokracisë në Veprim”<sup>30</sup>.

### Transporti i kutive të votimit

Gjatë procesit të monitorimit dhe grumbullimit të transportit të kutive të votimit nga qendrat e votimit deri në KKZ, dhe prej aty më pas monitorimi i transportit të tyre deri në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve në Fushë Kosovë, nuk raportohen raste të vonesave apo ndalesave të konvojit transportues gjatë rrugës.

### RIVOTIMI 23 JANAR 2011

Pas vendimit të Gjykatës Supreme për rivotim në Komunën e Mitrovicës, Komisioni Qendror Zgjedhor solli vendim që votimi për zgjedhje parlamentare në këtë komunë të përsëritet më 23 janar 2011. “Demokracia në Veprim” kishte monitoruar edhe këtë proces zgjedhor me vëzhgues,

<sup>30</sup> Dëbimi i vëzhguesve jashtë vendvotimit, apo dëmtimi i automjeteve të tyre.

të cilët në Komunën e Mitrovicës ishin sjellë nga komunat tjera të Kosovës<sup>31</sup>. Në përgjithësi procesi kishte qenë i qetë, pa ndonjë rast të raportimit të shkeljeve që do të mund të dëmtonin procesin.

Përgatitja e vendvotimeve në rivotimin e 23 janarit 2011, në Komunën e Mitrovicës në pjesën më të madhe të vendvotimeve, apo në 78,8% të tyre ishte bërë midis orës 6:00 dhe orës 7:00. Kjo kishte rezultuar me hapjen me kohë të të gjitha vendvotimeve<sup>32</sup>.

Mesatarja e numrit të anëtarëve të KVV-së për vendvotim (vv) ishte 7,1 anëtarë për vv, prej të cilëve 5,8 anëtarë ishin të gjinisë mashkullore dhe 1,8 anëtarë apo 25,5% të anëtarëve ishin të gjinisë femërore.

Materialet, si informatat si duhet të votohet, lista e subjekteve politike apo lista e kandidatëve ishin të pranishme në të gjitha vendvotimet. Po ashtu, për dallim nga zgjedhjet e 12 dhjetorit 2010, materialet, si llambat ultravjollcë apo spreji ishin të një cilësie më të lartë, pasi që nuk raportohen probleme në këtë aspekt. Por, prapëseprapë u evidentuan 9 vendvotime, ku këto materiale munguan gjatë përgatitjes së vendvotimeve dhe u siguruan pas ndërhyrjeve të Komisionit Komunal Zgjedhor.

I tërë procesi përsëri kishte marrë vëmendjen e gjithë aktorëve të inkuadruar, si dhe ishte monitoruar nga vëzhguesit e subjekteve politike, ata të organizatave, të shoqërisë civile, gjithashtu nga vëzhguesit ndërkombëtarë dhe nga mediat.

### **Procesi i votimit**

Procedurat e votimit, si: kontrollimi i ngjyrës në gisht, kontrollimi i dokumenteve të identifikimit, spërkatja e ngjyrës në gisht, ishin respektuar në masë të madhe nga ana e komisionarëve, kështu që nuk raportohen raste të shkeljeve në këtë aspekt. Vështirësi gjatë procesit të votimit hasen në tre vendvotime, ku shpesh votuesit nuk mund t'i gjenin emrat në listat e votimit. Nga ana tjetër, në 25 vendvotime raportohen raste kur një person asiston në më shumë persona gjatë votimit, si dhe në mbi 70% të vv raportohen raste të votimeve familjare.

### **Ambienti i votimit**

Gjatë procesit të rivotimit, ambienti i votimit raportohet të ketë qenë kryesisht i qetë, pa ndonjë incident të theksuar që do të ndikonte në proces. Shënohen gjashtë vendvotime, në të cilat për shkaqe të ndryshme ishte prishur atmosfera e qetë e votimit. Shqetësim tjetër paraqet mungesa e shumicës së anëtarëve të KVV-ve. Raste të tilla u raportuan në 3 vendvotime. Po ashtu, në 12 vv si

---

<sup>31</sup> Në pjesën veriore të Komunës votimi ishte mbajtur në vendvotime mobile, të cilat kishin një orar më të shkurtër të votimit dhe këto vendvotime nuk mund të monitoroheshin nga ana e vëzhguesve të "Demokracisë në Veprim" për shkak të hapësirës së vogël brenda këtyre vendvotimeve mobile si dhe për shkak të sigurisë së vëzhguesve.

<sup>32</sup> Përveç atyre në pjesën veriore të komunës

shkelje evidentohen raste të asistimit të votuesve nga ana e vëzhguesve, kurse në 9 prej tyre evidentohet propaganda politike brenda vendvotimit.




Figura 12, Paraqitja e numrit të vendvotimeve ku hasen disa nga dukuritë që ndikuan në ambientin e qetë të votimit.

Përndryshe nga vlerësimet e vëzhguesve të “Demokracisë në Veprim” më së shpeshti raportohen raste të votimeve familjare, si dhe të asistimeve të shumëfishta.

### Numërimi i votave

Në 71,6% të vendvotimeve procesi i votimit kishte përfunduar diku prej orës 19:00 deri në ora 20:00, kurse në pjesën tjetër të vendvotimeve edhe më herët, diku prej orës 18:00 deri në 19:00. Ky fakt siguroi që numërimi në të gjitha vendvotimet të fillojë midis orës 19:00 dhe 20:00 dhe të përfundojë në 92,6% të vendvotimeve qysh para mesnatës.

Gjatë fazës së numërimit të votave të rivotimit, nuk raportohen raste të shkeljeve si: prania e personave të paautorizuar në vendvotim, mungesa e shikimit të mirë në procedura, apo shkelje nga ana e anëtarëve të KVV-së. Në përgjithësi vlerësimi i vëzhguesve të “Demokracisë në Veprim” është që në 51,2% të vendvotimeve procesi i numërimit funksionoi normal dhe pa probleme. Kurse në një vv evidentohet një rast i parregullsisë që nuk do të ndikonte në rezultat, si dhe një rast në një vv, kur anëtarët e KVV-së plotësuan vendet e zbrazëta për kandidatë apo për subjekt politik në bazë të preferencave të tyre.







Figura 13, Vlerësimi i vëzhguesve mbi procesin e numërimit të votave i paraqitur në përqindje.

## ANALIZA E TRENDEVE

Që nga zgjedhjet e para të pasluftës së vitit 2000, ku pjesëmarrja në votime ka qenë rreth 79% në vazhdimësi është vërejtur një rënie konstante në numrin e qytetarëve me të drejtë vote që nuk kanë marrë pjesë në zgjedhje. Ky trend është ndalur në zgjedhjet e vitit 2009, ku kemi pasur një rritje të ndjeshme në krahasim me vitin 2007, me ç'rast përafërsisht pjesëmarrja ishte ngritur për 3% duke arritur në përqindje 43.2%. Zgjedhjet e fundit parlamentare të vitit 2010, në krahasim me zgjedhjet paraprake, po ashtu shënuan një rritje solide të pjesëmarrjes së qytetarëve në votime, duke kapur shifrën 45.29% apo 706,31 votues.

Nga viti 2000, numri i qytetarëve të regjistruar me të drejtë vote ka shënuar në mënyrë të vazhdueshme një rritje të konsiderueshme nga 913.179 sa ishin në vitin 2000, gati se u dyfishuan në vitin 2010, duke kapur shifrën e 1,632,276 votues të regjistruar. Vetëm nga zgjedhjet e kaluara të vitit 2009 ka pasur një rritje të numrit të votuesve të regjistruar prej 73,288 apo 4.4%.



*Figura 14, Paraqitja e trendeve të numrit të votuesve të regjistruar me të drejtë vote.*

Sipas komunave prinë me përqindjen dalëse në votime, Mamusha me 65.13%, pasuar nga Skenderaj me 59%, Drenasi me 55.95%, Prishtina 55,17%, si dhe Lipjani me 53,43 %. Me numrin më të vogël të qytetarëve, të cilët kanë shfrytëzuar të drejtën e tyre për të votuar edhe më tutje vazhdojnë të jenë komunat nga pjesa veriore e Kosovës: Leposaviqi 0.80%, Zveqani 1.86 %, Zubin Potoku me 6.24% dhe Mitrovica me 27,02%. Duhet konstatuar se në pjesët e tjera të Kosovës, ku kryesisht banon një numër i madh i komunitetit serb, krahasuar me zgjedhjet e kaluara kemi një rritje të jashtëzakonshme të daljes së qytetarëve që i takon këtij komuniteti, si p.sh.: në Partesh 51.62 %, në Shtërpçë 48.87%, Graçanicë 45.09% , Klllokot 46.79% dhe Ranillug 34.31%.




Figura 15, Paraqitja në përqindje e daljes së votuesve në votime, duke krahasuar komunat me numër më të madh të pjesëmarrjes së votuesve dhe ato me numër më të vogël.

### **Trendet e daljes në votim gjatë ditës së votimit**

Trendi i daljes së qytetarëve në votime gjatë procesit të ditës së votimit është matur sipas intervaleve kohore 10:00, 12:00, 15:00 dhe 17:00. Midis këtyre intervaleve kohore vërehet një dallim i konsiderueshëm. Përderisa deri në orën 10, mesatarisht në gjithë territorin e Kosovës kanë votuar 44.172, ndërkaq deri në orën 12 numri kishte arritur në 111.914. Orët e pasdites flasin për një dalje edhe më masive, në krahasim me orët e paradites, duke votuar deri në orën 15 227.328, kurse deri në orën 17 kjo shifër arriti deri në 289.375 qytetarë që kishin shfrytëzuar të drejtën e tyre për të votuar. Trendi më dinamikë i daljes së qytetarëve në votime del të jetë periudha pas orës 12 deri në orën 17. Kjo e dhënë mund të dalë si e tillë, kur merret parasysh koha shumë e ftohtë e ditës së mbajtjes së zgjedhjeve në mes të muajit dhjetor.




Figura 15, Paraqitja skematike e trendit të daljes në votime gjatë ditës së zgjedhjeve të 12 dhjetorit 2010.

## REKOMANDIMET:

### Për Institucionet Qendrore:

- Është e domosdoshme reforma e legjislacionit zgjedhor në Kosovë në mënyrë që të jetë në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare;
- Me qëllim të përfaqësimit më të drejtë të qytetarëve të Kosovës në institucionet përfaqësuese, Kosova nga një zonë e vetme (unike) zgjedhore, duhet të ndahet në disa zona zgjedhore;
- Me qëllim të rritjes së pjesëmarrjes sa më të madhe të partive politike dhe përfaqësimit më të gjerë në Kuvendin e Kosovës, pragu zgjedhor duhet të ulet nga 5% në 3 % për partitë politike, ndërsa për koalicionet të mbetet 5%.
- Kosova duhet të aplikojë sistemin e votimit me lista të hapura, sipas parimit një votë një kandidat;
- Afatet kohore për ankimin dhe procedim të ankesave nuk sigurojnë kohë të mjaftueshme për dorëzimin e ankesave, si dhe për shqyrtimin e tyre nga organet përkatëse (PZAP dhe Gjykata Supreme) duhet shqyrtuar mundësinë e zgjatjes së këtyre afateve;
- Përcaktimi me ligj i sanksioneve për subjekte politike, kandidatët e të cilëve fillojnë fushatën para kohës së përcaktuar me ligj;

### Për Institucionet që administrojnë procesin zgjedhor (KQZ, KKZ)

- Me qëllim që Komisioni Qendror Zgjedhor të mos ndikohet nga forma të ndryshme të presionit politik, duhet shikuar modalitetet alternative të përbërjes së KQZ-së, Komisioneve Komunale Zgjedhore dhe Këshillave të Vendvotimeve;
- Me qëllim të përfaqësimit të barabartë gjinor, organet kompetente duhet të sigurojnë përfaqësimi adekuat gjinor në përbërjen e anëtarëve të KKZ-ve dhe KVV-ve;
- KQZ duhet të sigurojë kohë të mjaftueshme për trajnime substanciale dhe cilësore për anëtarët e KVV-ve;
- Organet kompetente duhet të ndërmarrin gjitha masat për pastrimin e listave të votuesve, duke hequr personat e vdekur nga ato;
- Të zgjatet afati kohor i kundërshtimit dhe konfirmimit të listave të votuesve dhe të edukohen dhe informohet votuesit për mënyrën e kundërshtimit dhe konfirmimit të listës;
- KQZ duhet të gjejë forma lehtësuese të votimit për qytetarët, të cilët jetojnë jashtë vendit;
- KQZ duhet të përdorë edhe forma alternative me qëllim të edukimit të votuesve, si takimet me votues të rinj, publikimin dhe shpërndarjen e broshurave dhe forma tjera tërheqëse, të cilat zhvillohen gjatë tërë kohës, jo vetëm në prridhën parazgjedhore;
- KQZ duhet t'i ndërmarr të gjitha masat për të siguruar materialin senzitiv dhe josenzitiv të kualitetit të lartë;

- KQZ në bashkëpunim me institucionet e tjera kompetente duhet t'i ndërmarrin të gjitha masat që procesi i ditës së votimit të zhvillohet në pajtim me dispozitat ligjore dhe kushtetuese për sigurimin e një procesi zgjedhor të lirë, të drejtë dhe demokratik;
- Të sigurohet qasja e adekuate në vendvotim për personat me nevoja të veçanta;

### **Për organet që i trajtojnë ankesat PZAP, Gjykata Supreme**

- Institucionet kompetente ankimuese duhet t'i respektojnë afatet kohore të shqyrtimit të ankesave sipas dispozitave të parapara me ligj;
- PZAP dhe Gjykata Supreme duhet të shqyrtojnë me kompetencë secilën ankesë të parashtruar para tyre;

Për Subjektet Politike:

- Partitë politike gjatë fushatës zgjedhore duhet të respektojnë në përpikëri Kodin e Mirësjelljes së Subjekteve Politike, Kandidatëve dhe mbështetësve të tyre dhe duhet të fuqizohen masat ndëshkuese ndaj shkelësve të tij;
- Subjektet politike duhet të kenë kujdes në përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të KVV-ve;
- Partitë politike duhet të demonstrojnë në vazhdimësi vullnet dhe pjekuri politike për të garantuar zhvillimin e një procesi zgjedhor në përputhje me standardet ndërkombëtare;
- Rastet ku janë evidentuar parregullsitë dhe manipulimi i votave, institucionet kompetente kushtetuese duhet të ndërmarrin të gjitha masat që personat përgjegjës të dalin para drejtësisë;



Mendimet e shprehura në këtë tekst janë të autorit.

Ky publikim është bërë i mundur nga përkrahja e ofruar prej:

